www.mergata-info.de REVISTË PERIODIKE PËR MËRGATËN SHQIPTARE NË GJERMANI Nr.2, TETOR 2024

# MËRGATA



## AFARISTI I SUKSESSHËM NË GJERMANI

# ALBERT BUCOLLI

KÖNIGS-VILLEN
IMMOBILIEN GMBH

BUCOLLI
MALER & STUCKATEUR GMBH

Hotel Bel´vu
Stuttgarter str 21
70825 Korntal-Münchingen
01733774343
info@belvu.de
www.belvu.de
HOTEL BEL´VU
ALBERT BUCOLLI

deAlba
ARCH INT

# ALBERT BUCOLLI – STORJE SUKSESI E NJË AFARISTIT SHQIPTAR NË GJERMANI



Z. Albert Bucolli është një emër i njohur dhe i respektuar në biznesin shqiptar të diasporës. Nga përshkrimi i tij, kuptohet se ai është një njeri me një disiplinë të jashtëzakonshme dhe një përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj punës. Fillimet e tij, të cilat i kujton me krenari dhe përulësi, janë një shembull i përkushtimit dhe sakrificës që ka bërë për të arritur në sukses.

Në vitin 2006, kur z. Bucolli nisi aktivitetin e tij në Gjermani, kishte shumë sfida përpara tij, megjithatë, kurajo dhe përkushtimi, si dhe ndihma e bashkëpunëtorëve, kanë qenë kyçe në arritjen e qëllimeve të tij. Ai e sheh punën si një satisfaksion dhe është falënderues për të mirat materiale, morale dhe shpirtërore që ka marrë nga puna e tij.

Angazhimi i z. Albert Bucolli në përmirësimin dhe zhvillimin e biznesit në Gjermani është një dëshmi e suksesit të tij dhe e aftësisë për të ndikuar pozitivisht në mjedisin e biznesit. Ai është krenar si shqiptar të tregojë vlerat e komunitetit të tij, duke i bërë shembull për të tjerët përmes punës së palodhur dhe investimeve të vazhdueshme në afarizëm.

Me siguri, storja e tij është një inspirim dhe motivacion për shumë të tjerë dhe është një dëshmi e forcës dhe vizionit që mund të çojnë edhe në suksese në nivelin ndërkombëtar.

# INTERVISTË ME Z. ALBERT BUCOLLI, NJË PREJ AFARISTËVE TË SUKSESSHËM NË MËRGATË

Revista “Mërgata”: **Z. Bucolli, mund të na flisni pak për veten tuaj? Ku jeni lindur dhe çfarë arsimimi keni marrë? Po ashtu, si ishte angazhimi juaj në UÇK?**

**Albert Bucolli:** Unë jam Albert Bucolli, i lindur në Poklek të Vjetër të Drenasit (Drenicë). Kam kryer shkollën fillore në Poklek të Vjetër dhe Gjimnazin në Drenas, në shkollën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”. Në vitin 1998, në moshën 18-vjeçare, iu bashkova Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shërbeva në „Brigadën e 114-të Fehmi Lladrovci“ në Zonën Operative të Drenicës deri në fund të vitit 1999. Në luftë ishim edhe 23 ushtarë nga familja ime e ngushtë, Bucolli. Pas përfundimit të luftës, kam punuar në Ministrinë e Rendit Publik të asaj kohe nga viti 2000 deri në vitin 2003.

Revista “Mërgata”: **Në cilin vit keni emigruar në Gjermani dhe si ndodhi kjo?**

**Albert Bucolli:** Kam emigruar në Gjermani më 17 korrik 2003. Dëshiroj të përmend se bileten e udhëtimit ma bleu djali i axhës, Blerim Bucolli, për të cilin jam shumë mirënjohës. Kur kam arritur në München, kam pasur vetëm 20 euro në xhep.

Revista “Mërgata”: **Sa ishte e vështirë të largoheni nga familja dhe të emigroni?**

**Albert Bucolli:** Ishte shumë e vështirë, sidomos të largohesha nga nëna, e cila gjithmonë më mbështeste dhe kishte frikë se mos nuk do të kthehesha më. Ajo më ndihmonte me copa buke gjatë shërbimit tim në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe kishte shqetësime të thella për sigurinë time. Pas përfundimit të luftës, ishte një vendim i vështirë të largohesha nga familja për të kërkuar një jetë më të mirë në emigrim.

Revista “Mërgata”: **Kur keni filluar të punoni në Gjermani, cilat ishin sfidat dhe vështirësitë kryesore?**

**Albert Bucolli:** Në vitin 2003, kur kam ardhur në Gjermani, kishte një ligj që kërkonte dy vjet për të marrë leje pune. Gjatë kësaj periudhe, e kam shfrytëzuar kohën për të mësuar gjermanisht dhe për të ndjekur një shkollim në „Handwerkskammer Stuttgart“ për të fituar të drejtën për të hapur një kompani ndërtimi. Pas përfundimit të shkollimit dhe marrjes së lejes, hapëm kompaninë e parë, „SGN BAU BUCOLLI“, në vitin 2006. Pas një kohe, themeluam edhe kompaninë tjetër „Bucolli Maler & Stuckateur GmbH“, e cila kryen punimet në ndërtim komplet, nga fillimi deri në dorëzimin e çelësave.

Revista “Mërgata”: **Si lindi interesimi juaj për patundshmëri dhe çfarë rol luan kompania „Königs Villen Immobilien GmbH“ në këtë drejtim?**

**Albert Bucolli:** Investimet e mia në patundshmëri janë një pasion i thellë që është rritur me kalimin e kohës. Kur vendosa të hy në këtë fushë në vitin 2012, nuk e kisha qëllim të kompletohesha si sipërmarrës, pasi isha i kënaqur me aktivitetet e mia në „SGN Bau Bucolli“. Megjithatë, dëshira për tu marrë me veprimtarinë afariste, me patundshmëri u bë e fortë, dhe tani jam përkushtuar plotësisht në këtë sektor në realizimin e projekteve e mia të patundshmërisë.

Revista “Mërgata”: **Ju së fundmi keni blerë një hotel dhe jeni duke e rinovuar. Kur planifikoni të bëni hapjen zyrtare?**

**Albert Bucolli:** Po, në janar 2024, kemi blerë një zinxhir hotelesh nga një familje gjermane dhe jemi duke e rinovuar dhe dizajnuar. Do të

lançojmë një markë të re për këtë zinxhir dhe do ta shtrijmë atë edhe në disa shtete të tjera të Evropës. Do t'ju informojmë me kohë për hapjen zyrtare, ku jeni të ftuar edhe ju që të jeni pjesë e kësaj ngjarjeje të rëndësishme në rrugëtimin tim afarist.

Revista "Mërgata": **Nëse do të rendisnit pronat që keni në Gjermani, ku do ta vendosnit veten në këtë renditje?**

**Albert Bucolli:** Do ta vendosja veten në vendin ku ndodhen njerëzit që punojnë dhe kontribuojnë. Nuk ka rëndësi rendi i numrave. Më e rëndësishme është që të ndjehesh i lumtur me punën që bën dhe të jesh i shpërblyer me përpjekjet dhe përkushtimin tuaj.

Revista "Mërgata": **Si ka ndikuar puna në botën e biznesit në ndryshimin tuaj personal?**

**Albert Bucolli:** Mund të them se kam evoluar, por nuk kam ndryshuar thelbësisht. Jam ende i njëjti njeri që mban fjalën, respekton familjen dhe miqtë dhe ushqen pasionet e tij me përkushtim, veçanërisht kur ato i shërbejnë klientëve dhe familjes time.

Revista "Mërgata": **Ju shohim gjithmonë të shoqëruar nga vëllai juaj, Arianiti. Çfarë roli luan ai në iniciativat tuaja?**

**Albert Bucolli:** Arianiti dhe unë kemi kaluar 27 vite së bashku, që nga mosha 13 vjeçare. Kemi punuar krah për krah dhe kemi përballuar çdo vështirësi së bashku. Kemi një lidhje të veçantë dhe nuk mund të ndaheshim nga njëri-tjetri. Jam me fat që kam një vëlla me karakter të fortë që më mbështet me sinqeritet dhe përkushtim në çdo ide. Po ashtu, kam edhe vëllanë e vogël, Taulantin, që gjithashtu na mbështet dhe na ndihmon shumë në biznes.

Revista "Mërgata": **Si i konsideroni marrëdhëniet me bashkëpunëtorët dhe punonjësit tuaj?**

**Albert Bucolli:** I konsideroj shumë të rëndësishëm dhe kam një raport të fortë motivimi dhe vlerësimi me ata që mbështesin vizionin dhe investimet e mia në kompani. Shpresoj që ata më shohin si një mik me të cilin mund të komunikojnë hapur, pavarësisht kërkesave të larta që kam, të cilat i aplikoj edhe ndaj vetes time, jo vetëm ndaj tyre.

Revista "Mërgata": **Cili është sekreti i suksesit tuaj, z. Albert Bucolli?**

**Albert Bucolli:** Sekreti është puna e palodhur. Filloj ditën në orën 7:00 të mëngjesit dhe e mbyll pas mesnatës. Kam një disiplinë të fortë në punë dhe përpiqem të jem një model për bashkëpunëtorët e mi, të cilët fatmirësisht e kanë vlerësuar këtë përkushtim dhe më kanë mbështetur.

Revista "Mërgata": **Ju jeni gjithashtu një kontribuues i madh në aksionet humanitare dhe ngjarjet kulturore. Çfarë ju motivon për këtë angazhim?**

**Albert Bucolli:** Familja ime, sidomos nëna ime, është burimi i motivimit tim për të ndihmuar të tjerët. Më ka mësuar që të ndihmojmë ata në nevojë dhe kjo është diçka që do të vazhdoj ta bëj gjithmonë.

Revista "Mërgata": **Në fund, cili është mesazhi juaj për lexuesit e Revistës "MËRGATA" në Gjermani?**

**Albert Bucolli:** Jeta është e lidhur ngushtë me familjen dhe punën. Fëmijët janë gjykatësit tanë më të mirë dhe ai që e kupton rëndësinë e punës së ndershme është gjithashtu i gatshëm të përballojë sfida të mëdha. Unë vazhdoj të mbaj betimin e dhënë në vitin 1998 për të kontribuar për atdheun tim, dhe besoj se ky duhet jetë mesazh dhe obligim për të gjithë bashkatdhetarët tanë që punojnë dhe jetojnë në Gjermani.

*Intervistoi: Argjend Hasani*

## KÖNIGS VILLEN IMMOBILIEN GMBH – EKSPERTË NË MENAXHIMIN E PASURIVE DHE KUJDESIN PËR NDËRTESAT

Königs Villen Immobilien GmbH është një kompani e njohur në industrinë e pasurive të paluajtshme dhe menaxhimit të objekteve, duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë për pronarët e ndërtesave rezidenciale dhe komerciale në Gjermani. Me një përvojë të gjatë në treg dhe një ekip të kualifikuar, ne jemi të specializuar në çdo aspekt të menaxhimit të objekteve, nga mirëmbajtja e përgjithshme deri te riparimet dhe përmirësimet teknike.

Në Königs Villen Immobilien GmbH, qëllimi ynë kryesor është të sigurojmë që çdo pronë të ruajë vlerën e saj dhe të ofrojë një mjedis të sigurt dhe funksional për banorët dhe përdoruesit. Ne ofrojmë një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë mirëmbajtjen e përditshme të sistemeve teknike, pastrimin e përhershëm të zonave të brendshme dhe të jashtme, si dhe menaxhimin e riparimeve dhe emergjencave.

Si një partner i besueshëm për pronarët e pronave dhe investitorët, Königs Villen Immobilien GmbH është e përkushtuar për të ofruar një shërbim të personalizuar që plotëson nevojat dhe kërkesat specifike të çdo klienti. Ne përdorim teknologji moderne dhe një qasje proaktive për të identifikuar dhe zgjidhur çështjet para se ato të shndërrohen në probleme të mëdha, duke kursyer kohë dhe para për klientët tanë.

Përveç kësaj, ekipi ynë është gjithmonë në dispozicion për të ofruar këshilla profesionale mbi çështjet e menaxhimit të pasurive, duke përfshirë optimizimin e kostove operative dhe përmirësimet e mundshme që mund të rrisin efikasitetin dhe komoditetin e ndërtesave.

Në Königs Villen Immobilien GmbH, ne besojmë në transparencë, profesionalizëm dhe cilësi të qëndrueshme. Kjo qasje na ka bërë një nga kompanitë më të respektuara në sektorin e menaxhimit të objekteve në Gjermani.





# DIPL.ARKITEKTE ALBA KRASNIQI

## PASIONI YNË ËSHTË DIZAJNIMI

*„deAlba Arch", e specializuar në transformimin e hapësirave përmes arkitekturës inovative dhe kreativitetit të dizajnit*

Gjatë viteve të fundit, unë Alba Krasniqi, si arkitekte profesioniste kam qenë në gjendje të demonstroj, dhe të implementoj në mënyrë profesionale kreativitetin tim për një dizajn miqësor, konform dëshirave dhe kërkesave të klijentëve dhe mjedisit.

Stafi i zyrës tonë në „deAlba Arch", jemi të specializuar në transformimin e hapësirave përmes arkitekturës inovative dhe dizajnit të brendshëm që lidhë sofistikimin estetik me funksionalitetin praktik. Qasja jonë karakterizohet nga një vëmendje e përpiktë ndaj detajeve dhe një përkushtim për të krijuar mjedise që nuk janë vetëm vizualisht mahnitëse, por gjithashtu përmirësojnë mënyrën se si njerëzit jetojnë dhe punojnë. Ne krenohemi me integrimin e praktikave të qëndrueshme dhe teknologjisë më të avancuar për të ofruar projekte që janë moderne me fokus në materialet dhe produktet me cilësi të lartë, natyrale dhe të riciklueshme.

Ne si ekip, përpiqemi të zhvillojmë zgjidhje të përsonalizuara në të gjitha fazat e shërbimit për projektet, qofshin ato publike apo private, duke pasqyruar përkushtimin tonë ndaj përsosmërisë dhe pasionit tonë për të shtyrë kufijtë e dizajnit.

Dizajni modern karakterizohet nga një estetikë e pastër, e hijshme që thekson thjeshtësinë, funksionalitetin dhe një integrim të qetë me mjedisin përreth. Ky stil arkitektonik vazhdon të ndikoj në hartimin bashkëkohor të banimit. Shtëpitë moderne që i dizajnojmë ne janë të njohura për linjat e tyre të drejta dhe të pastra. Linjat horizontale dhe vertikale që shpesh theksohen duke krijuar një ndjenjë ekuilibri dhe harmonie.

Ne kemi realizuar me sukses punime në Landin Baden-Würtenberg të Gjermanisë, ku kemi realizuar implementimin e dizajnimin të klasit të mesëm dhe të lartë në sektorin e objekteve hoteliere. Në Stuttgart të Gjermanisë, në Basel të Zvicres dhe në Kroaci kemi punuar dhe dizajnuar vila, dyqane mode, shtëpi banimi, etj.

Poashtu kemi realizuar shumë dizajne në kryeqytet, Prishtinë si dhe në tërë Kosovën.

*Me respekt  Alba Krasniqi Akitekte e diplomuar*

# Pasioni ynë është dizajnimi



Dhoma e gjumit



Kuzhina



Banjo



Banjo



Dhoma e madhe



Tryezaria

ALBAKRASNIQI®
+383 (45) 582 525
designdealba@gmail.com
Rr. Tirana, Prishtine 10000.
deAlba



# PROF. DR. MED. DR. PHIL.
# HALIL KRASNIQI
## KIRURG DHE ZBULUES SHKENCOR

Prof. Dr. med. Dr. phil. Halil Krasniqi, kirurg dhe zbulues shkencor, themelues i klinikes vaskulare në spitalin gjerman, ka lindur në Pejë ku perfundoi shkollën fillore dhe ate të mesme. Kurse shkollen e mjekësisë e mbaroi në Mitrovicë. Pas diplomimit në studimet e para në Fakultetin Klinik te Defektologjisë në Universitetin Filozofik, ka vazhduar studimet ne Mjekësinë humane dhe është diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin Heinrich Heine në Düsseldorf në vitin 1998.

Specializimin e Kirurgjisë së Përgjithshme, Krasniqi e përfundoi në Klinikën Universitare të Kirurgjisë nën oput të Prof. Dr. Dr. Dr. Röher, kurse Specializimin e Kirurgjisë Vaskulare po në të njëjtën klinikë Universitare nën oputin e Prof. Dr. Dr. Dr. W. Sandmann.

Prof. Krasniqi posedon mbi 16 specializime dhe ka diplomuar në dy Fakultete duke mbrojtur dy doktoratura shkencore në fushën e Kirurgjisë Vaskulare, në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Düsseldorfit, në Fakultetin Filozofik me vazhdim akademik të Profesorit të shkencave të kirurgjisë.

Në vazhdim Profesori mbaroi specializime të shumta pas universitare si ato për trajtimet Intervencionale dhe Endovaskulare si Specialist Endovaskular dhe Kirurg Endovaskular në Düsseldorf dhe Berlin, me super specijalizim të Radiologjisë Intervente.




Specializimet e mëtutjeshme vazhduan edhe në shkenca tjera medicionale sikur diplomimi në shkencat e Sexualitetit, shkencat e Psikologjisë familjare si dhe specializimeve të tjera në trajtimet kirurgjike Hibride.

Ekspert i Kirurgjisë, i vlerësuar nga shkenca Gjermani si Shef i Klinikës Vaskulare dhe Kirurgjisë së Përgjithshme në Spitalin St. Willehand në Wilhelmshaven, degë Univerzitare e Universitetit Carl von Ossietzky në Oldenburg, karrierën e tij e vazhdoi ai gjatë pozitës si Drejtor i kirurgjisë vaskulare në St. Johannes Hospital në Varel. Së fundi Profesor Krasniqi ishte Shef i kirurgjisë vaskulare në Helios Klinikum në Pforzheim. Tani Krasniqi është Drejtor i Klinikës së Kirurgjisë së Përgjithshme, Vaskulare dhe Estetike „Chirurgie Krasniqi“ në Calw të Gjermanisë.

Si Docent ligjërues i Kirurgjisë në Fakultetin e mjekësisë në Universitetin Heinrich Heine në Düsseldorf, në Universitetin Carl von Ossietzky në Oldenburg, në Universitetin Ruprecht Karls në Heidelberg dhe së fundi në Kolegjin UBT Univerzitetin e Shkencave, Biznesit dhe teknologjis në Prishtinë, Kosovë, Profesor Halil Krasniqi është korife i mbështetjes shkencore në Evropë.

Krasniqi zbuloi shifken Bidirektionale në vitin 2020, ku fitoi vendin e katërt në garat e zbulimeve shkencore nga çmimi Arthur Fischer në Stuttgart dhe është vlerësuar ndër 10 zbulimet më të mira shkencore nga 200 shkencëtar të Gjermanisë. Zbulimi i Shifkes KRASSA është patentuar me patentën e nivelit botëror numër 20 2018 107 159. Shifka KRASSA përdoret nga disa disiplina mjekësore të cilat trajtojnë sëmundjet vaskulare me metodën intervencionale dhe atë endovaskulare. Shërben për hyrjen në Arterie dhe Vena. Kirurgët vaskular, Kardiologët, Radiologët, Angiologët mund ta përdorin shifken duke marr parasysh ekspertizën e tyre në trajtimin vaskular.



Eksperti vaskular për herë të parë në historinë e kirurgjisë vaskulare në Kosovë, implantoi Stentprotezat në Aortën Torakale, Abdominale dhe në Arteriet e veshkave. Gjithashtu në vitin 2016 ai trajtoi me metodën intervencionale Aneurizmen e A. Subclavia mbi 12 cm.

Në vitin 2015 Krasniqi përdori për herën e parë trajtimin e Venave të sëmura me RFITT (Radiofrequenz termo terapi bipolare) duke e etabluar këtë metodë në Kosovë dhe Shqipëri.




Në vitin 2016, Profesor Krasniqi implantoi Prothese e parë Aortobiiliacale në Kosovë, tek një pacient 62 vjeçar me Aneurizmen Abdominale mbi 11 cm. Pas këtij trajtimi vazhduan edhe trajtimet tjera të patologjisë së Aortes supra dhe infrarenale.

Në vitin 2017 ai trajtoi me TEVAR një 57 vjeçar me Dissekacion të Aortës Thorakoabdominale për herë të parë në Kosovë. Pas këtij trajtimi vazhduan edhe trajtimet tjera Endovaskulare të patologjisë së Aortës Torakale, Aneurizmës dhe Disekacionit.

Në vitin 2018 Krasniqi gjithashtu për herë të parë në Kosovë Implantoi Stentet në Arteriet renale tek pacienti 15 vjeçar me tandem stenoz dyfishe renale. Në vitin 2021 implementoi në Kosovë Krasniqi, trajtimin e sëmundjeve të venave me ngjitës biologjik VenaSeal.

Krasniqi, është Profesor i Kirurgjisë në UBT, Prishtinë dhe ekspert, Kirurg i Përgjithshëm dhe Kirurg Vaskular në Kosovë. Obligimi dhe aktiviteti i tij mjekësor vazhdon me vite edhe në spitalet e vendlindjes në Prishtinë.

Aktualisht Prof. Dr. Dr. Halil Krasniqi ka kryer mbi 28.000 operacione nga Kirurgjia e Përgjithshme, Vaskulare, Ortopedike, Gjinekologjike, Estetike etj.

Kurse specializimet dhe titujt shkencor të arritur me diplomime në fakultetet përkatëse i përfundoi me afate shkencore. Ai është Autor i disa librave shkencore, fetare, politike, letrare dhe anëtar i disa shoqatave shkencore dhe teknologjike i cili kontribon rregullisht me shkrime, publikime dhe evidenca te trajtimit.

Përgjatë aktiviteteve shkencore Profesor Krasniqi obligohet edhe me shkencat politike dhe është politikan, deputet komunal i partis së pamvarur politike (FWV) në vendbanimin e tij në Gjermani.








Shkruan Abdullah Troshupa

# HAVA BEKTESHI, AMBASADORE E KULTURËS SHQIPTAR NË GJERMANI

Hava Bekteshi u lind në Gostivar-Maqedonia e Veriut. Ajo është një shqiptare e suksesshme e cila që nga viti 1993 jeton në Hamburg të Gjermanisë. Përtej profesionit të saj si ekonomiste dhe mësuese e gjuhës gjermane (studimet i mbaroi në Universitetin e Hamburgut), ajo tani është bërë shumë e njohur për publikun gjerman dhe shqiptar, përmes instrumentit muzikor të çiftelisë. Nga viti 2010, duke parë interesimin publikut të Hamburgut për çiftelinë, Hava filloi te merret më intensivisht e tanimë edhe profesionalisht me aktrim (Deutsches Schauspielhaus) dhe shfaqje muzikore me instrumentin popullor çiftelinë, duke u angazhuar kështu edhe nëpër festivale të shumta gjermane dhe ndërkombëtare, ku paraqitjet e saj filluan të bëjnë bujë nëpër shumë medie.

Hava Bekteshi, në këtë mënyrë të veçantë e përfaqësoi melosin dhe kulturën shqiptare në shumë vende evropiane dhe nxiti kuriozitet e adhurim për instrumentin kombëtar shqiptar. Nga kjo befasi e këndshme, rrodhën edhe bashkëpunime të tjera për shfaqje të koncerteve të shumta me artistë ndërkombëtar nga zhanret e ndryshme muzikore, si elektro, psychadelic, jazz, pop, oriental, etj. Në vitin 2017 realizoi edhe një album me dy këngë "Bukuroshja e Lales" dhe "Delay" në stilin ÇIFTELI-PSYCHADELIC, me një grup të djemve gjermanë të grupit "Love Songs". Ndër projektet më të rëndësishme të karrierës së saj, është edhe performimi vjetor në projektet e Deutsches Schauspielhaus (Teatri Gjerman i Hamburgut), ku ajo e përfaqëson me dinjitet kulturën shqiptare, përmes



tingujve të çiftelisë, dhe si kulmi i të gjithë këtij suksesi, është performimi i këngës së saj shqipe, “Tingellon teli i çiftelisë”, në Elbfilharmoninë e Hamburgut, ku ajo e përfaqësoi komunitetin shqiptar me 25 maj 2019, para 2.500 shikuesve, në sallën e madhe të filharmonisë gjatë koncertit “Stadtlied”, i cili u transmetua edhe nëpër shumë televizione dhe medie të ndryshme gjermane. Pjesëmarrja e Hava Bekteshit ne Elbfilharmoninë e Hamburgut, i la përshtypje edhe Televizionit të njohur gjerman RTL-Nord, ku ajo u përzgjodh si protagonistja kryesore e shfaqjes dhe aty u prezantua me këngën shqipe dhe kryesisht me instrumentin e çiftelisë.

Hava është tani pjesë e Elbphilharmonisë, ku aty angazhohet në shumë projekte, si instrumentiste me çifteli dhe këngëtare.

Çiftelia e Havës bën një jehonë që tërheqë vëmendjen e adhuruesve muzikorë dhe është bërë pjesë e pandashme e teatrit dhe filmit gjerman. Hava Bekteshi viteve të fundit ka qenë e ftuar të jetë pjesëmarrëse si konkurruese nëpër festivale mbarëkombëtare, ku edhe është nderuar dhe dekoruar me disa nga çmimet:









- -Festivali Folklorik “I këndojmë lirisë” Edicioni i 19-të, Klinë-Kosovë; Debutanti më e mirë e Festivalit (8 qershor 2019)
- -Festivali Tradicional kombëtar Folklorik “Anadrinia Jehon 2018” Edicioni i 17-të;
- Çmimi: Muhamet Malsori si këngëtarja me e mirë e festivalit.
- -Festivali Folklorik gjithëkombëtar “RAPSODIA SHQIPTARE” Skenderaj;
- Debutantja më e mirë e festivalit Festa e Plisit të bardhë.
- -Shoqata “Bytyçi”, Tiranë, vitin 2014 mori vendimin të ndaj çmimin me titullin artistik “Fatime Sokoli, Bilbili këngës në Malësi të Gjakovës”.
- -Shoqata mbarëkombëtare”Bytyçi” në Tiranë Prizren ndau Mirënjohje Speciale për punën, angazhimin dhe kontributin e dhënë me vite.
- -Certificate of Appreciation awarded to: Hava Bekteshi for her artistic performance at the Conference “Albanian DREAMin & LEAPin 2020”
- -Festivali Poetik mbarëkombëtar “Flakadani i kujtesës” -Mirënjohje për pjesëmarrjen artistike me Çifteli
- EtnoFest Edicioni i 9-të;
- -Mirënjohje për kontributin e dhënë gjatë festivalit me Përformancë me këngë dhe çifteli RTV- Festina;
- -Mirënjohje për pjesëmarrjen online në Festivalin e Folklorit “Sofra Shqiptare 2020”.

**Fotot i realizuan: Kai Bienert, Christian Bartsch, Gesche Jäger, Claudia Höhne, Alaa Taliaa**

KRYEZIU
Steuerberatung



**Diplom-Betriebswirt Jahir Kryeziu**
**Steuerberater**
*Bockenheimer Anlage 46*
*60322 Frankfurt am Main*

**Tel.: +49 69 505064150**
**info@kanzlei-riedberg.de**
**www.kanzlei-riedberg.de**

**Shërbimet kryesore ligjore, tatimit dhe kontabilitetit përfshijnë:**

- Asistencë ligjore biznesi
- Ngritje biznesi
- Hartim kontratash, kontrata për punonjësit dhe kontrata tjera të biznesit
- Asistencë në zbatim dhe menaxhim të kontratës
- Udhëzim-zbatim për tatimet
- Zgjidhje të strukturimit të tatimeve
- Shërbime të këshillimit të transferimit të çmimeve
- Regjistrim biznesi
- Shërbime pajtueshmërie tatimi
- Tatim në të ardhura të korporatës
- Shërbime të pajtueshmërisë së TVSh-së
- Shërbime të pajtueshmërisë të tatimeve personale
- Shërbime kontabiliteti
- Shërbime pagash
- Procedim të dhënash
- Përgatitje raportesh financiare.




# DOKTOR HAMIT MANXHOLLI, MJEKU I SUKSESSHËM SHQIPTAR NË GJERMANI

Nga Kosova për në Gjermani kanë emigruar shumë kuadro profesionale për shkaqe ekonomike dhe politike, po ashtu edhe nga fusha e shëndetësisë. I tillë është edhe migrimi i mjekut Dr. Hamit Manxholli nga Mikushnica e komunës së Skenderajt.

Hamit Manxholli shkollën fillore e mbaroi ne Prekaz të Epërm, ndërsa të mesmen në Skenderaj. Studimet i ndoqi deri në semestrin e nëntë në Fakultetin e Mjekësisë në UP-së në Prishtinë. Pas mbylljes së Universitetit të Prishtinës në mënyrë të dhunshme nga forcat serbe, në vitin 1992, u detyrua t'i vazhdojë dy vitet e tjera në Shqipëri, ku edhe diplomoi në Universitetin e Tiranës - (UT) në Tiranë.

Dr. Hamit Manxholli, fillimisht mërgoi për disa vite në Zvicër, afër Zürichut, dhe më vonë u vendos në qytetin Passau të Republikës Federale të Gjermanisë. Mjeku, Hamit Manxholli, disa vite ka punuar në Kirurgji të Përgjithshme, Vaskulare e Traumatologji e më vonë në Mjekësinë Interne, deri në specializimin e tij si Internist në vitin 2014. Nga viti 2017, Dr. Manxholli profesionin e mjekut e bën si i pavarur në Ordinancën Internistike dr. Hamit Manxholli, si mjek familjar dhe internist, ku njëkohësisht edhe bashkëshortja e tij punon si infermiere.



Pacientë të shumtë, si gjermanë, shqiptarë dhe të nacionaliteteve të tjera, të cilat i kryejnë vizitat e tyre në ordinancën e mjekut Hamit Manxholli janë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga ai dhe stafi i mrekullueshëm shëndetësor në këtë ordinancë.

Mikpritja, profesionalizmi, empatia e Dr. Hamit Manxhollit, si dhe përkujdesi i stafit shëndetësor ndaj pacientëve, e sidomos tani në kohë pandemie, ka rritur imazhin e kësaj ordinance, gjë që është bërë një rritje enorme të vizitave shëndetësoredhe ka rritur po ashtu edhe numrin e pacientëve në përgjithësi.

Kredibiliteti dhe autoriteti i Dr. Hamit Manxhollit, e sidomos sukseset e tij, mërgatën shqiptare në Passau dhe rrethinë si dhe në tërë Gjermaninë e bëjnë krenar.

Doktor Hamit Manxholli është i martuar me Mirsijen, e cila me profesion është infermiere dhe kanë tre fëmijëve. Vajza e madhe Fjolla 20 vjeçare, studion Biznes-Informatikë në Universitet, kurse vajza e dytë, Florentina 18 vjeçare dhe djali Floriani në Gjimnaz në Passau.

Mjekut të suksesshëm shqiptar në Gjermani, doktor Hamit Manxhollit i urojmë suksese të mëtutjeshme në profesionin dhe misionin humanitar në shërbim të pacientëve.



Dr. Hamit Manxholli me stafin e tij në Ordinancën Internistike



Doktor Hamit Manxholli me familjen e tij

# SHKOLLA SHQIPE “RILINDJA” NË HEILBRONN

Përpjekjet për të rihapur shkollën shqipe në Heilbronn nuk ishin edhe aq të lehta, mirëpo me vullnetin dhe me një iniciativë krejtësisht vetanake, veprimtari dhe shkrimtari Lulzim Osmanaj arriti që brenda një kohe të shkurtër të organizoj dhe të i ftoj dhjetëra mërgimtarë rreth vetes dhe të shpalos planin e tij para komunitetit shqiptar por edhe para zyrtarëve të Konzullatës së Republikës së Kosoves në Stuttgart.

Ai me gjithë sakrificën dhe vullnetin e palodhshëm të një atdhetari dhe veprimtari të shquar shqiptar, arriti që brenda një kohë të shkurtër, brenda një viti të hap tri paralele të shkollës shqipe në Heilbronn.

Çdo gjë kishte filluar duke diskutuar me mërgatën shqiptare, sidomos me prindërit, me fëmijët u bisedua me njëri-tjetrin për mundësinë e rihapjes së shkollës shqipe i dhe për fuqizimin e Shoqatës BESA dhe bashkimin e shqiptarëve dhe gjetjen e kuadrove të reja.

Me 08.02.2023 në ambientet e Restaurantit shqiptarë „Oda“ në Heilbronn, u mbajt takimi i shumë pritur, ku u diskutuan hapat e mëtejme rreth rihapjes së mësimit plotësues. Pjesmarrës në këtë organizim ishin zyrtarët e Konzullatës së Republikës së Kosovës, në krye me konzullen Lumturie Lipoveci dhe zv. konzullin Gramoz Berisha me seli në Stuttgart, ku edhe treguan mbështetje por edhe përvojat mbi punën dhe hapat që duhet ndërmarrim për shkollën shqipe

Iniciatori dhe veprimtari Lulzim Osmanaj pas këtij takimi të frytshëm, trokiti derë më derë në shkollat gjermane në Heilbronn dhe rrëthinë, duke kërkuar një klasë për mbarvatjen e mësimit plotësues shqip. Shkolla „Grünewaldschule“ në Böckingen të Heilbronnit, ku drejtoresha e shkollës Eva Happold, ishte ajo që ofroj bashkëpunim dha dritën e gjelbërt për mbarvajtjën e mësimit.




Me 24 mars 2023 pas një aktiviteti të bujshëm Këshilli Organizativ në krye me shkrimtarin dhe studiuesin Lulzim Osmanaj arritën ta rihapin shkollën me mësim në gjuhën shqipe. Ishte ditë e premte me diell prindërit të shoqëruar me fëmijët e tyre për në shkollë me mësim në gjuhën shqipe, shumica prej tyre në dorë mbanin buqeta me lule si shenjë nderi dhe respekti për mësuesin Lulzim dhe konsullen Lumturie Lipoveci. Nga shumica e prindërve vlenë të përmenden dy mësues dhe veteranë të arsimit, z.Skender Alimetaj dhe z.Abaz Imeri, një veprimtar i palodhur kudo që e kërkon nevoja, nuk heziton të jetë prezent dhe të ndihmoj për çdo nevojë, si materialisht apo edhe në organizime të ndryshme për çështje kombëtare. Cen Berisha, apo siç e quajmë ne në Heilbron “Dardani”, e solli mbesën në shkollë dhe shumë prindër tjerë me fëmijët e tyre bënë që ky fillim të jetë i mbarë. Duke parë interesimin e madhë të prindërve shqiptarë për fëmijët e tyre, u pa e udhës qe të hapet edhe paralelja e dytë në „Schilerschule“, po në Heilbronn. Ndërsa, me 26. 04. 2024 duke mos u ndalur, Shkollës Shqipe „Rilindja“ iu shtua edhe një paralele e trëtë e mësimit plotësues në „Rosenauschule“ në Heilbronn.

Në prani të Konzullit të Republikës së Kosovës në Stuttgart z.Hamdi Berbatovci dhe zv.Konzullit Gramoz S. Berisha, u hap paralelja e tretë të mësimit plotësues në „Rosenauschule". E pranishme ishte mësuesja në Grünerwaldschule, zonja Raza Llugaxhiu Vranovci, mësuesi Tasim Refki Kryeziu, prindër, nxënës, veteranë të arsimit, si Skender Alimetaj, Abaz Imeri, njështu dhe kryetari i shoqatës „BESA", Besnik Thaqi, si dhe Erblin Lekaj, kryetar i Këshillit të Prindërve në Heilbronn. Mësueses së re Verona Kastrati iu uruan punë të mbarë dhe suksese në të ardhmen. Konzulli Hamdi Berbatovci, për nxënësit kishte sjellur tekstet shkollore, njëherit Erblin Lekaj shpërndau dhurata dhe buqeta të bukura me lule.

Numri i nxënësve për momentin në tri paralelet ku po mbahet mësimi plotësues në gjuhën shqipe është mbi 60-të nxënës, dhe dita e ditës po shtohet, gjithashtu po shtohen edhe kërkesat për hapjen e pikave tjera me mësim në gjuhën shqipe edhe në rrethinën e Helbronnit.

Me angazhime të përbashkët arrihen rezultate që inkurajojnë fëmijët tanë për suksese të mëtutjeshme. Kështu që Këshilli i Prindërve falënderon të gjithë ata që ndihmuan dhe po ndihmojnë për funksionimin e shkollës me mësim në gjuhën shqipe në Heilbronn, shkollë kjo që tani e mbanë emrin "R I L I N D J A".

Gani Kryeziu









Shkruan: Musa Mulolli

# BIBË NOKAJ, VEPRIMTAR I DALLUAR NË MËRGATËN SHQIPTARE NË GJERMANI



Bibë Nokaj u lind më 23. 05.1948 në Marmull të Gjakovës. Shkollimin e mbaroi në Bishtazhin. Në vitin 1970 emigroi në Gjermani, ku jeton edhe sot me bashkëshorten dhe tre djemtë.

Pas emigrimit në Gjermani edhe z. Bib Nokaj sikur e gjithë mërgata nuk qëndron duarkryq. Ai u mobilizua dhe iu rrek organizimit të aktiviteteve atdhetare në radhë të parë sensibilizimin e qytetarëve dhe strukturave shtetërore gjermane për kauzën tonë shqiptare në Kosovë, si dhe mbështetjen e gjithmbarshme të atdheut. Burgosjet, represioni dhe mohimi i të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, shkaktoj protesta tek mërgata shqiptare në Gjermani, ku z. Bibë Nokaj ishte pjesëmarrës i rregullit e shpesh edhe organizator, si ajo e datës 04.04.1998 para Rathaus në Hagen, kundër represionit dhe gjenocidit serb në Kosovë.

Nevoja për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditës shqiptare tek brezi i dytë i mërgatës e motivon z. Bibë Nokajn për hapjen e shkollës me mësim plotësues në gjuhën shqipe në Hagen, dhe më 1985 së bashku me komunitetin shqiptar të Hagenit ia arrijnë qëllimit për hapjen e shkollës shqipe në Hagen.

Në vitin 1991 së bashku me një grup atdhetarësh e formojnë shoqatën „Nëna Terezë" me seli në Dortmund, në të cilën z. Bibë Nokaj zgjidhet kryetar i „Komisionit të Kontrollës", nga e cila shoqatë janë dërguar në Shqipëri disa maune me ndihma dhe ilaçe.

Në mars te vitit 1992 z. Bibë Nokaj zgjidhet kryetar i Klubit Kulturor „Anton Çetta", në Hagen, ku së bashku me kryesinë e klubit, lokalin e saj e shndërruan në vatër patriotike, kulturore e financiare për atdheun. Në këtë vatër përformuan nga fatosat deri te yjet e estradës shqiptare, politikanë e intelektualë të shquar si profesor Anton Çetta, dr. Fazli Syla, akademik Mark Krasniqi, dr. Zekerija Cana, Engjëll Sedaj, Dom Lush Gjergji, dr. Mujë Rugova, Azem Shkreli, i cili ishte edhe anëtar nderi i klubit. Komplet qeveria në ekzil me Kryeministër Bujar Bukoshin, etj.

Në mars te vitit 1992 z. Bibë Nokaj zgjidhet kryetar i Klubit Kulturor „Anton Çetta", në Hagen, ku së bashku me kryesinë e klubit, lokalin e saj e shndërruan në vatër patriotike, kulturore e financiare për atdheun. Në këtë vatër përformuan nga fatosat deri te yjet e estradës shqiptare, politikanë e intelektualë të shquar si profesor Anton Çetta, dr. Fazli Syla, akademik Mark Krasniqi, dr. Zekerija Cana, Engjëll Sedaj, Dom Lush Gjergji, dr. Mujë Rugova, Azem Shkreli, i cili ishte edhe anëtar nderi i klubit. Komplet qeveria në ekzil me Kryeministër Bujar Bukoshin, etj.

Me një unanimitet të plotë dhe përkrahje të gjerë nga komuniteti shqiptar i Hagenit dhe rrethinës, z. Bibë Nokaj zgjidhet kryetar i komisionit për Fondin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 3%, për Hagen, Wuppertal, Solingen, Remscheid, Gevelsberg, Ennepetal, Lüdenscheid, Altena dhe Iserlohn, si dhe anëtar i komisionit për Landin e NRW-së. Kurse gjatë kohës së luftës në Kosovë z. Bib Nokaj e udhëheq edhe „Shtabin e Emërgjencës" me të cilin shtab arrin t`i grumbullojë jashtë detyrimeve mujore, në aksione të ndara për kohë të shkurtër 83.000 dhe afër 120.000 Marka gjermane për Fondin e 3%-it.



Pajtimtari i gjaqeve, prof. Anton Çetta dhe veprimtari Bibë Nokaj






agener Zeitung

Samstag, 20. Juni 1998

# 107 000 Mark für Kosovo-Hilfe

## Hagener Gemeinde unterstützt Landsleute in der Unruheprovinz

**Hagen.** (rd/dpa) Der Konflikt in der Krisenregion Kosovo hat die Kosovo-Albaner in Deutschland zum Handeln bewegt.

Ein seit Jahren eingerichtetes Spendenkonto wächst an, allein aus Hagen sollen in den letzten beiden Monaten 107 000 Mark für Hilfsgüter zusammengetragen worden sein. Das erklärte gestern Bibe Nokaj, Vorsitzender des Vereins „Anton Cetta" in Hagen, auf Anfrage. Er unterstrich, daß das Geld ausschließlich für Lebensmittel und zu Bildungszwecken verwendet wird. WP-Informationen, nach denen ein Bote Geld aus Hagen direkt ins Krisengebiet geschafft habe, wollte Nokaj nicht bestätigen. „Die Spenden werden über die offiziellen Kanäle und Stellen verteilt."

Die Gemeinde der Kosovo-Albaner trifft sich regelmäßig im Eilper Vereinshaus. „Wir wollen unseren Landsleuten helfen, unsere Sprache und Kultur trotz des serbischen Drucks zu erhalten", erklärt Nokaj. Er kennt die Gerüchte, nach denen sich auch Asylbewerber aus Hagen dem Widerstand in der Krisenregion angeschlossen haben. „Wer das ist oder wie viele das sind, wissen wir nicht."

Nach Angaben der serbischen Behörden versuchen Angehörige der illegalen Kosovo-Befreiungsarmee (UCK) wichtige Strecken zu unterbrechen. Die UCK kontrolliert mitunter fast alle Straßen in der Unruheprovinz.

"107 000 Marka ndihmë për Kosovën"- Shkruan gazeta lokale gjermane "Hagener Zeitung", E shtune, 20 qershor 1998

Shkruan: Xhafer Leci

# SHPALOSJE HISTORIKE NGA VEPRIMTARIA ATDHETARE MËRGATËS SHQIPTARE NË GJERMANI

## VRASJA TRE IDEOLOGËVE TË KOMBIT VËLLEZËRVE JUSUF E BARDHOSH GERVALLA DHE KADRI ZEKA

Tre ideologët e kombit tonë, Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, kishin mësuar për veprimet mesjetare greko-serbe, për sundimin dhe copëtimin e tokave shqiptare. Ata duke qenë të vendosur për arritjen e progresit kombëtar, për zhvillimin ekonomik të shqiptarëve, do duhej demaskuar me fakte sundimin e politikës pushtuese serbo-greko-shoveniste. Atëherë' domosdoshmërisht do duhej përgatitur popullin mendërisht për t'i hyrë kësaj udhe të vështirë dhe me pasoja të mëdha, deri tek çlirimi i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, për bërjen e Shqipërisë Etnike.

Duke parë se, as pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia komuniste titiste, në raport me shqiptarët, nuk kishte ndryshuar nga sistemi i mbretërisë të Jugosllavisë Serbo-Kroato-Sllovene, e cila kishte ushtruar gjenocid, vrasje, burgosje e shpërngulje, ndaj shqiptarëve të pafajshëm.



Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla

Pjesëmarrja në bashkëqeverisje e udhëheqësve shqiptarë të partisë komuniste të Jugosllavisë, ishte tërësisht e trullosur, mbas njëfarë "bashkim – vëllazërimi", të cilët nuk e kishin kuptuar, apo nuk donin ta kuptonin, se ajo parullë, ishte vetëm një gënjeshtër e radhës, e sajuar nga Beogradi, për mashtrimin e më tejmë të shqiptarëve.

Për arritjen e barazisë kombëtare, do duhej mobilizuar popullin. Populli pas demonstratave të vitit 1968, të shtypura me dhunë ushtarake e policore nga Beogradi, duke parë se ato nuk na sollën kushedi se çfarë rezultatesh progresive. Sikur edhe demonstratat e vitit 1971 në Kroaci, kundër të cilave Beogradi përdori po ashtu dhunë policore dhe ushtarake. „Po citoj shkrimtarin kroat Branko Horvat, cili në librin e tij me titull „Kosovsko pitanje" botuar në vitin 1990, shkruan: „Shqiptarët në Jugosllavi jetonin sikur të ishin zezakë të Afrikës së Jugut gjatë kohës së Aparteidit".

Atëherë në pranverën e vitit 1981, u rioganizuan demonstrata nga këta tre ideolog udhëheqës të Mërgatës tonë, këtu në Perëndim. Mos të harrojmë të përmendim edhe veprimtarë, organizatorë, e atdhetarë të tjerë të hershëm të Mërgatës tonë, si z. Emin Fazlija, alias Emil Kastrioti, Kryetar i Beslidhjes Kombëtare Demokratike Shqiptare, tash i ndjerë, ndjesë pastë, Heroin e Kosovës Enver Hadri dhe dëshmorët Vehbi Ibrahimi e Musa Hoti! Jusufi, Kadriu e Bardhoshi, zgjodhën mënyrën dhe rrugën më të mirë organizative, nëpërmes demonstratave e protestave paqësore, për internacionalizimin e çështjes Shqiptare, në veçanti të Kosovës, nëpër shumë vende të Perëndimit. Aktiviteti i tyre nuk ishte krejt

ilegal, siç e quajmë neve koha e ilegalës. Këto tri personalitete atdhetare e organizative, ishin publike nëpër protesta, tubime dhe botime. Përmes grupeve ilegale dhe kontakteve të tyre me mërgimtarë, besnik, atdhetarë e liridashës, protestat dhe demonstratat u bënin masive.

Këtu në Perëndim merrnin pjesë nga 500 deri në 4 mijë protestues. Bota perëndimore filloi të mendojë, sadopak, për padrejtësitë që u ishin bërë shqiptarëve, gjatë historisë mijë-vjeçare. Demonstratat masive dhe paqësore u zhvilluan në gjithë hapësirën shqiptare, nën pushtimin dhe sundimin e Jugosllavisë diktatoriale tititste. Mjerisht, vetëm në Shqipërinë e diktaturës komuniste të Enver Hoxhës, nuk u zhvillua asnjë demonstratë! Dhe vetëm pas 6 javë dite, kur Beogradi filloi ta akuzojë Shqipërinë, për përzierje në punët e brendshme, atëherë Enver Hoxha e ngriti zërin në mbrojtje të shqiptarëve.

Demonstratat e vitit 1981 në Perëndim i dhanë mesazhe që qarta botës perëndimore, se shqiptarët janë të vendosur të punojnë deri në realizimin e të drejtave të tyre kombëtare. Beogradi me nervozizëm shihte internacionalizimin e të drejtave të mohuara, deri atëherë pak të njohura për Botën Demokratike. Prandaj, projektoi plane për vrasjen-eliminimin e këtyre Tre heronjve të Kosovës.

Të dielën, më 17 janar 1982, rreth orës 22:15, në udhëtim e sipër, me veturë, përmes radios gjermane, mësova për vrasjen e "tre jugosllavëve", në Untergruppenbach-Heilbronn të Gjermanisë. Të nesërmen mësova se, nga UDB-a Jugosllave ishin vrarë atdhetarët: Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Ishte ditë me borë, ngrica dhe mjegull. Nga dhimbjet që ndjeja, më dukej sikur edhe qielli po rëndonte mbi kokën time. Pata fatin që i njoha, mora pjesë nëpër demonstrata, dhe në ceremoninë e varrimit, bashkë me vëllain tim Balën, kushëririn Begun, Nami Ramadani, Jakup Biçkaj, Ibrahim e Jusuf Shala, një mik imi, turk, Osman Helvaci e disa të tjerë. Aty i njoha edhe prindërit e tyre, Nanën Ajshe dhe bacin Pajazit Zeka, i njohur në popull si Ziti.

Te varrezat, shumë njerëz po qanin dhe ishin të pikëlluar, po qaja edhe unë. Më afrohet Qamil Isufi, kushëri i parë i Saime Isufit, të fejuarës së Kadri Zekës dhe më thotë "Xhafer pse po qanë?"

I them: "Po më dhimbsën shumë këta tre patriotë që na i vrau shkjau". Qamili më thotë: "Unë Kadri Zekën e kam pasur djalë tezeje". Për informimin tim, për pjesëmarrje në demonstrata, ceremoni përkujtimore, për leximin e shtypit të kohës, të cilin e shpërndaja edhe unë, e falënderoj shumë mikun tim besnik e atdhetar shumë të çmuar Z. Nami Ramadani, nga Tenava e Tetovës, si dhe Bacin Selim Koca, nga Polaci i Drenicës, tash i ndjerë, ndjesë pastë.

Edhe pas vrasjes së Jusufit, Kadriut dhe Bardhoshit, të tre Heronjtë të Kosovës, aktivitetet nuk pushuan. Demonstrata, protesta dhe shtypi për informim nuk munguan kurrë. Ato i organizonin Hasan Malaj, Saime Isufi, Sabri Maxhuni-Novosela, Abdullah Prapashtica, Xhafer Shatri, Xhafer Durmishi, Emin Fazlija, Enver Hadri, Ramadan Gashi, Riza Kadrijaj-Budakova, Reshat Sahitaj, Behare Rexhepi, e të tjerë. Demonstratat vazhduan edhe në kohën e pluralizmit të viteve 1990-ta, deri në çlirimin definitiv të Kosovës më 1999, dhe ato ishin më masivet, që mbanë mend historia e Mërgatës.

Lavdi jetës dhe veprës atdhetare të Heronjve Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla.

Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë dhe çlirimin e vendit dhe popullit tonë!



Atentati i UDB-së jugosllave ndaj vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, më 17 janar 1982 në Untegrupenbach të Gjermanisë (Bild)

# MËRGATA SHQIPTARE NË GJERMANI

Fillimet e emigrimit të shqiptarëve në drejtim të Republikës Federale në Gjermani janë shënuar në mes të viteve 60-ta dhe fillim të viteve 70-ta. Emigrimi i shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, përkatësisht të Kosovës, Maqedonisë Veriore, Luginës së Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes e Malit të Zi, si dhe të Shqipërisë, në Gjermani është shkaktuar nga disa faktorë dhe rrethana, si në hapësirë, po ashtu edhe në kohë. Emigrimi ka ndodhur në disa etapa dhe rrethana të caktuara historike.

Etapa e parë e emigrimit të shqiptarëve në Gjermani ka filluar në fund të viteve 60-ta dhe fillim viteve 70-ta, si pasojë e kushteve të rënda socio-ekonomike dhe politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Asokohe, ekonomia gjermane po përjetonte një hov në zhvillimin e ekonomisë së saj, sidomos në industrinë e ndërtimit. Në bazë të një marrëveshje të Ministrisë së Punës së RFGJ-së dhe Ministrisë së Punës së ish-RSFJ-së, bëhej e mundur që punëtorët shqiptarë dhe të nacionaliteteve të tjera në ish-Jugosllavi, të punësoheshin si punëtorë sezonal në Gjermani.

Etapa e dytë e emigrimit të shqiptarëve, sidomos nga Kosova në Gjermani ka ndodhur në fillim të viteve 80-ta. Si pasojë e përndjekjes dhe dhunës sistematike serbo-jugosllave, ndaj rinisë dhe popullatës shqiptare, kudo në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, e sidomos pas Demonstratave Studentore të vitit 1981, ku u kërkuan të drejtat e barabarta me popujt e tjerë, si dhe avansimi i statusit të Kosovës në Republikë, ku dhuna dhe represioni ndaj shqiptarëve u intensifikua.

Këto demonstrata ishin shuar me dhunë policore nga aparati shtetëror serbo-jugosllav, ku për pasojë mbetën të vrarë qindra studentë shqiptarë. Shumë të rinj për t` ju shmangur më të keqes, përndjekjes, keqtrajtimeve, rrahjeve brutale, burgosjeve, për ta shpëtuar jetën, ishin detyruar të arratisen nga trojet stërgjyshore dhe t'ia mësyjnë rrugëve të mërgimit drejt Gjermanisë, Zvicrës, Belgjikës, Francës, Holandës, SHBA-ve, etj., për t'u strehuar përkohësisht atje.

Etapa e tretë e emigrimit të shqiptarëve nga Kosova dhe trojeve shqiptare në ish-Jugosllavi në drejtim të Gjermanisë dhe shteteve tjera perëndimore ishte në fillim të viteve 90-ta, si pasojë e agresionit dhe shtetrrethimit serb të Kosovës, si dhe dhunës sistematike serbe, burgosjeve, vrasjeve, përndjekjes së dhunshme të intelektualëve, aktivistëve politik, si dhe të rinjve shqiptarë, përjashtimit me dhunë nga puna, mbyllja e shkollave dhe fakulteteve, etj. Me suprimimin e Autonomisë së vitit 1974, shqiptarët e Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë, u zhveshën nga të gjitha të drejtat elementare njerëzore që u garantonte Kushtetuta e vitit 1974. Kështu që, Serbia agresore, me ndihmën e ish-Armatës famëkeqe jugosllave, APJ-ja dhe policisë serbe, vendosi Kosovën në shtetrrethim të plotë ushtarako-policor, duke rrahur, keqtrajtuar dhe vrarë qytetarët e pafajshëm, vetëm pse i takonin nacionalitetit shqiptar.



Etapa e katërt e emigrimit të shqiptarëve nga Kosova në Gjermani dhe shteteve të tjera perëndimore ka ndodhur po ashtu edhe në vitet 1998/99 gjatë Luftës në Kosovë dhe 2001/02 gjatë Luftës në Maqedoninë Veriore, Luginën e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës.

Ky emigrim ishte i përmasave të mëdha, sidomos gjatë Luftës në Kosovë, ku makineria serbe po vriste dhe masakronte qindra-mijëra shqiptarë, kishte djegur dhe shkatërruar mijëra shtëpi dhe kishte kryer një gjenocid dhe etnocid të paparë, duke depërtuar deri në qershor të vitit 1999, një milion shqiptarë nga Kosova.

Vlerësim:

Vlerësohet se sot në Gjermani, sipas të dhënave jo zyrtare jetojnë afër 400.000 shqiptarë. Qendra të rëndësishme të mërgatës shqiptare në Gjermani janë kryesisht në Berlin, Hamburg, Mynih, Shtutgart, Frankfurt, etj.

Shkruan: Argjend Hasani

# ROLI I MËRGATËS SHQIPTARE NË GJERMANI

Roli i mërgatës shqiptare kudo në Evropë dhe në botë, sikurse edhe në Gjermani ishte jetik në mbijetesën e popullit shqiptar në ish-Jugosllavi që prej fillim viteve 60-ta e deri në vitin 1999. Republika Federale e Gjermanisë, po ashtu ishte një strehë e sigurt për refugjatët shqiptarë në të gjitha etapat e emigrimit, si pasojë e okupimit të egër serb.

Mërgata shqiptare pas emigrimit në Gjermani, nuk qëndroi duarkryq. Ajo menjëherë u mobilizua dhe iu rrek organizimit të aktiviteteve atdhetare në radhë të parë në sensibilizimin e vendeve mike për kauzën tonë kombëtare shqiptare në Kosovë dhe ish-Jugosllavi, dhe mbështetjen e gjithmbarshme të atdheut me të gjitha mënyrat dhe mundësitë që kishin në dispozicion. Situata politike në trojet shqiptare kudo në shtetin e atëhershëm jugosllav po rëndohej.

Kërkesat e studentëve shqiptarë në Demonstratat e vitit 1981, për avancimin kushtetues nga një Krahinë Autonome, në Republikë, nga klika komuniste serbo-jugosllave u injoruan dhe këto demonstrata me dhunë të egër fashisoide u shtypën me gjak. Që nga viti 1981, Kosova ishte vënë në shtetrrethim të plotë ushtarako-policor serb. Kishte filluar përndjekja sistematike e grupeve atdhetare, intelektualëve, studentëve dhe qytetarëve shqiptarë. Dhuna, represioni, burgosjet dhe shkelja e të drejtave të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, pas vitit 1981, shkaktoi reagime dhe demonstrata të shumta nga popullata shqiptare në mbrojtje të drejtave kombëtare për liri dhe barazi, të cilat si gjithnjë u shuan me gjakun e njomë të shumë të rejave dhe të rinjve shqiptarë dhe kështu duke vazhduar deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës nga thundra e egër gjakatare serbe.

Të gjitha organizimet, si atdhetare, politike, arsimore, kulturore, luftarake, logjistike, financiare, etj., u organizuan dhe u mbështetën nga subjektet e ndryshme politike, shoqatat, klubet, asociacionet e ndryshme që vepruan dhe veprojnë në kuadër të mërgatës shqiptare.

Një kontribut në realizimin e aktiviteteve të shumta në sendërtimin e ëndrrës shekullore për Liri dhe Pavarësi, dhanë aktivistët e shumtë të mërgatës shqiptare në Gjermani. Lëvizjet e para atdhetare të mërgatës shqiptare në Gjermani në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare në ish-Jugosllavi, filluan në fillim të viteve 70-ta. Fillimisht ato nuk ishin të profilizuara edhe aq mirë për shkak të kontradiktave ideologjike. Një pengesë e madhe e unifikimit të mërgatës shqiptare në Gjermani, ishte Shërbimi i Sigurisë së Brendshme, e njohur ndryshe si UDB-ja jugosllave. Pjesëtarët e këtij shërbimi sekret ishin të kamufluar kudo dhe kishin për qëllim zbulimin, pengimin dhe likuidimin e figurave të shquara kombëtare që vepronin në kuadër të grupeve të ndryshme atdhetare në shërbim të Lëvizjes Kombëtare për çlirim nga kthetrat serbosllave. I tillë ishte fati i disa intelektualëve, ku edhe u likuiduan, si: Vehbi Ibrahimi, Kadri Zeka dhe Vëllezërit Gërvalla. Veprimtaria e aktivistëve të shquar në mërgatë, vëzhgohej në çdo hap. Për politikën jugosllave, veprimtarët shqiptarë ishin shndërruar halë në sy, kështu që hienat serbe ishin bërë sikurse hije dhe i përndiqnin në çdo vend. Fatkeqësisht kishte edhe shumë mërgimtarë servil që për interesa të caktuara kishin shitur shpirtin e tyre tek djalli dhe kryenin akte tradhtie dhe pabesie për kapjen e pjesëtarëve të Lëvizjeve Atdhetare Shqiptare. Një akt i tillë i eliminimit të figurave të shquara kombëtare, ishte vepra makabre e UDB-së jugosllave në eliminimin e vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, që u vranë më 22 shkurt të vitit 1982 në Untegrupenbach të Gjermanisë. Me vrasjen e veprimtarëve të shquar Kadri Zeka dhe Vëllezërve Gërvalla, ishte menduar se shqiptarët nga frika do të tërhiqeshin nga aktivitetet kombëtare, mirëpo efektet ishin të kundërta, lëvizjet e ndryshme u masivizuan, u forcuan dhe u bashkuan dhe kështu ata tërë potencialin e tyre intelektual, atdhetar dhe financiar e vunë në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare në ish-Jugosllavi.

## Përkeqësimi i gjendjes politike dhe të sigurisë në atdhe

Gjendja ishte bërë edhe më e rëndë, sidomos pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989, që atëbotë njihej si Kushtetuta e 1974-ës. Ky suprimim kishte ndodhur me një presion të jashtëzakonshëm ushtara-

ko-policor serb.

Si kundërpërgjigje, legjislatura e re e Kuvendit të Kosovës, me 2 korrik 1990, para dyerve të Kuvendit të mbyllur, shpallën Kosovën të barabartë me njësitë e tjera jugosllave.

Reagimi i Serbisë, ishte i menjëhershëm. Politika hegjemoniste e Serbisë, e ndihmuar nga aparati shtetëror jugosllav, vendosi masat e jashtëzakonshme dhe vuri Kosovën në shtetrrethim të hekurt ushtarako-policor. Ngjarjet zhvilloheshin me shpejtësi të madhe në dëm të popullatës shqiptare në Kosovë dhe ish-Jugosllavi. Së pari, iu ndalua hyrja përfaqësuesve shqiptarë në Parlamentin e Kosovës, kishte filluar përndjekja dhe burgosja e deputetëve, profesorëve, akademikëve, studentëve dhe intelektualëve. Me 5 korrik 1990, mbyllen mediumet e vetme në gjuhën shqipe, Radio-Televizioni i Prishtinës dhe gazeta e vetme e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja". Në po atë vit ndodhën helmimet e nxënësve shqiptarë dhe ndarja e tyre në baza nacionale. U bë largimi shqiptarëve nga puna që punonin në polici, administratë publike, shëndetësi dhe fabrika. Në vitin 1991 u vendosën masat e dhunshme nga Serbia, dhe në krye të dikastereve krahinore u vendosën dhunshëm në polici, universitet, shkolla, spitale, fabrika etj. Kështu që me plotë e kuptimin e fjalës jeta u paralizua. Duke parë gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej Kosova pas agresionit hegjemonist serb, elita intelektuale shqiptare, ndërmori masat e menjëhershme për një vetorganizim politik në rrethana okupimi. Gjendja politike dita-ditës po keqësohej edhe më shumë, dhuna sistematike kundër çdo gjëje shqiptare nuk po njihte kufijtë njerëzor, gjendja socio-ekonomike, sidomos pas largimit me dhunë nga puna po ndjehej kudo, kështu që shqiptarëve po iu bëhej e pamundur edhe vetë ekzistenca.

Që me fillimin e viteve 90-ta, qindra e mijëra qytetarë shqiptarë të Kosovës për shkak të agresorit serb në Kosovë migruan dhe u strehuan për të kërkuar mbrojtje në shtetet perëndimore. Pas migrimit të tyre, ata edhe për asnjë moment nuk qëndruan duarkryq, por u mobilizuan në grupe të ndryshme atdhetare politike dhe apolitike, dhe pa hezitim me të gjitha forcat dhe mundësitë u vunë në shërbim të mbështetjes dhe çlirimit të atdheut. Për vite të tëra mërgata përmes Fondit të Republikës së Kosovës, të njohur si "Tre përqindëshi", ka mbështetur organizimin e sistemit politiko-shoqëror paralel në të gjitha lëmenjtë e jetës. Thuaja se të gjitha aktivitetet zhvilloheshin fshehurazi nga regjimi, nëpër objekte private, pasi që agresori serb kishte uzurpuar dhe mbyllur të gjitha institucionet dhe objektet publike dhe shtetërore për shqiptarët. Kështu që për vite të tëra remintencat ishin burimi i vetëm financiar për mbijetesën e popullatës shqiptare në Kosovë. Thuajse nuk kishte shtëpi, ku të paktën një person që nuk kishte emigruar.

Në vitin 1997, durimit dhe rezistencës pasive po i vinte fundi dhe Kosova po hynte në një fazë tjetër të rezistencës së armatosur, ku edhe u formuan celulat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilat kishin për qëllim shporrjen e armikut gjakatar serb përfundimisht nga Kosova. Mobilizimi për luftë në Kosovë dhe në mërgatë ndodhi sidomos pas vrasjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari me familje. Mërgata shqiptare, kudo në botë, po ashtu edhe në Gjermani iu përgjigj kushtrimit për çlirimin e atdheut në të gjitha format, si me mobilizimin e ushtarëve vullnetarë, ndihma financiare, logjistike dhe ndihma të ndryshme bamirëse e humanitare, si në ushqim, veshmbathje dhe barna. Mërgata me qëllim të



mbështetjes së luftës çlirimtare kishte themeluar edhe Fondin “Vendlindja Thërret”. Fond ky, ku mërgimtarët kontribuan në formë vullnetare financiare për të mbështetur luftën e drejtë dhe të shenjtë të popullit shqiptar të Kosovës për Liri dhe Pavarësi. Shumë grupime atdhetare dhe politike, si parti, shoqata, klube, asociacione dhe biznese shqiptare, pa dallim u organizuan dhe u bashkuan për të mbështetur dhe për t’u bërë pjesë e pandashme e kauzës kombëtare për liri e pavarësi.

Së pari filluan me organizimin e aktiviteteve atdhetare dhe takimeve informative me përfaqësuesit e shteteve mikpritëse dhe pastaj filluan me organizimin e dhjetëra demonstratave masovike nëpër metropolet evropiane me qëllim të sensibilizimit të institucioneve evropiane dhe botërore me çështjen e pazgjidhur të Kosovës. Pas okupimit klasik të Kosovës nga okupatori serb, pushuan së funksionuari të gjitha institucionet legale në Kosovë. Deri te një situatë erdhi pasi që okupatori serb, kishte uzurpuar dhe mbyllur për shqiptarët të gjitha objektet ku vepronin institucionet, si: Kuvendin dhe Qeverinë Kosovës, Gjykatat, Shkollat dhe Universitetin, Radio-Televizionin e Prishtinës, Pallatin e shtypit “Rilindja”, Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, Institutin Albanologjik dhe atë të Historisë, Muzeun Kombëtar, Qendrat e mjekësisë familjare, Spitalet rajonale, Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës, Pallatin e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, Klubet dhe objektet sportive, si dhe shumë objekte të tjera kryesore dhe ndihmëse.

Kështu që, popullatës së pambrojtur shqiptare në Kosovë nuk i mbeti asgjë tjetër, pos të vetorganizohet në lëmenj të ndryshëm në formë paralele në mënyrë që të mbijetohej dhe të rezistohej okupimit të egër serb.

Popullata shqiptare e Kosovës, ishte mbi 90%, dhe kishte ardhur koha e një vetorganizimi dhe rezistence ndaj okupimit të egër serb në të gjitha format, në mënyrë që të sendërtohej vullneti i popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi, të mbajtur me Referendumin e vitit 1992. Lidhja Demokratike e Kosovës, me në krye me Presidentin Ibrahim Rugova, dhe spektrin e gjerë politik dhe intelektual unifikuan qëndrimet e tyre dhe të bashkuar, u vunë në krahë të Lëvizjes Kombëtare për sensibilizimin e çështjes kombëtare shqiptare nëpër botë, me qëllim të çlirimit përfundimtar të Kosovës nga agresioni serb.

## Demonstratat e mërgatës shqiptare për sensibilizimin e diplomacisë ndërkombëtare për çështjen e Kosovës

Si kudo nëpër botë, po ashtu mërgata shqiptare para dhe pas Demonstratave të vitit 1981, ku kërkohej Kosova Republikë, e deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës, në qershor të vitit 1999, asnjëherë nuk pushoi së organizuari me qindra e mijëra demonstrata paqësore për sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar për gjendjen e rëndë të popullit shqiptarë në Kosovë dhe ish-Jugosllavi, si pasojë e okupimit serbo-sllav.

Mërgata shqiptare, si kudo në Evropë, SHBA dhe Australi në kontinuitet, jo vetëm se ishte aktive në lobimin dhe promovimin politik dhe diplomatik të çështjes kombëtare në kancelaritë e ndryshme botërore për çështjen e Kosovës, por ajo nuk pushoi as edhe njëherë së reshturi në promovimin dhe prezantimin e vlerave kombëtare e kulturore në vendet mikpritëse.

## Kontributi financiar i mërgatës në Fondin e Republikës së Kosovës

Për të mbajtur gjallë të gjithë sektorët e nevojshëm, si në arsim, shëndetësi, kulturë, sport dhe bamirësi, në atdhe duheshin mjete, mjete këto të cilat me mund dhe sakrificë u siguruan për vite të tëra nga mërgimtarët tanë kudo në botë, po ashtu edhe në Gjermani, bashkatdhetarët tanë ndanë mjete financiare për çdo muaj nga tre për qind të pagës së tyre për Fondin e Republikës së Kosovës që ishte themeluar në egzil. Me këto mjete të bashkatdhetarëve tanë në mërgim, u financuan dhe u mbështetën thuaja

të gjitha aktivitete atdhetare, politike, arsimore, shëndetësore, humanitare dhe sportive në atdhe.

Në kushte okupimi, me një organizim, angazhim, me përkrahjen masovike dhe me shumë sakrificë, shqiptarët arritën të ruajnë të pa përkulur unitetin dhe identitetin kombëtar shqiptarë në periudhën e okupimit të egër serb. Mërgata shqiptare ishte shtylla kryesore e të hyrave buxhetore për mbijetesën e popullit të robëruar shqiptar nga Serbia.

## Mbështetja e mërgatës për Luftën Çlirimtare të Kosovës

Pas fillimit të përkeqësimit të situatës së përgjithshme të popullatës shqiptare në Kosovë dhe krijimit të celulave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rezistenca në Kosovë po merrte dimensione të tjera, duke kaluar nga rezistenca kombëtare pasive, në rezistencë të armatosur aktive. Dhuna, represioni, hegjemonizmi dhe nacionalizmi serb e kishte arritur kulmin. Politika paqësore dhe rezistenca pasive kishte shterur të gjitha mundësitë që së bashku me faktorin ndërkombëtar të arrijnë një marrëveshje paqësore me Serbinë për dhënien fund të agresionit dhe okupimit serb mbi Kosovë. Shumë të rinj dhe të reja në Kosovë kishin humbur shpresën se pa luftë mund të çlirohej Kosova. Lëvizje të tilla atdhedashëse për çlirimin e atdheut, tanimë kishin filluar të farkoheshin edhe tek të rinjtë, për të cilët vitet po kalonin e liria nuk po agonte dot.

Të mërzitur e të lodhur, me mallin e mërgimtarit që nuk po mund të vizitonin të afërmit e tyre, sepse Kosova ishte në shtetrrethim të plotë ushtarako-policor të Serbisë, disa mërgimtarë ia kishin arritur të vizitojnë ilegalisht Kosovën, mirëpo disa nga ta u arrestuan nga policia serbe dhe u rrahën për vdekje, dhe disa prej tyre edhe u vranë. Ndërsa, disa të tjerë së bashku me qytetarë që po emigronin në Evropë, po u tregonin bashkatdhetarëve të tyre në mërgatë për dhunën e egër sistematike serbe në Kosovë po bëhej e padurueshme.

Shumë djem të rinj në mërgatë, që nga viti 1997, e sidomos që nga masakrat e Drenicës dhe rezistencës, si dhe rënies së Komandantit Legjendar Adem Jashari me 5, 6 dhe 7 mars 1998 e deri në çlirimin përfundimtar më 10 qershor 1999, iu bashkëngjitën Luftës çlirimtare për Çlirimin e Kosovës.

## Pas afro një shekulli sakrificash, më në fund Liria dhe Pavarësia e Kosovës

Pas masakrave të shumta, depërtimeve me dhunë dhe shkatërrimeve masovike kundër popullatës shqiptare dhe katastrofës humanitare, Aleanca më e fortë në botë, NATO-ja, me 24 mars 1999, në orën 20, filloi bombardimin e caqeve serbe në ish-Jugosllavi. Kështu që pas një lufte të përgjakshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bombardimit 78 ditësh të caqeve forcave ushtarake dhe kriminale serbe, me 10 qershor 1999, arrihet Marrëveshja e Kumanovës, ku Serbia agresore kapitullon. Në marrëveshje u vendos që në Kosovë të vendosën 50 mijë ushtarë paqëruajtës të NATOS-s, të njohur si KFOR. Për një afat shumë të shkurtër ata arritën që t'i dëbojnë nga Kosova qindra-mijëra ushtarë, policë dhe grupe terroriste paramilitare serbe. Pas shumë vuajtjeve, sakrificave, masakrave, pas afro një shekulli të agresionit serbo-çetnik në Kosovë, kishte ardhur fundi. Bilanci i agresionit gjakatarë serb ishte i madh, afro 13 mijë shqiptarë ishin vrarë nga makineria vrastare serbe, në mesin e të vrarëve kishte edhe fëmijë, gra, e të moshuar. Një milion qytetarë shqiptarë ishin depërtuar me dhunë nga Kosova, ishin granatuar, djegur e shkatërruar mbi njëqindmijë shtëpi shqiptare, etj. Pas agimit të lirisë, edhe përkundër plagëve të freskëta nga lufta, popullata u mobilizua në rindërtimin e gjithë asaj që e shkatërroi lufta.

U kthyen pas përfundimit të luftës menjëherë, afro një milion refugjatë shqiptarë që ishin depërtuar nga Kosova, dhe që ishin strehuar në shtetin amë, në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, dhe kudo në Evropë, SHBA, Kanada e deri në Zelandën e Re dhe Australi. Entuziazmi për ta shijuar lirinë ishte shumë i madh, sa që shumë refugjatë shqiptarë hoqën dorë nga qëndrimi i përhershëm edhe nga shtetet më të pasura të botës, po ashtu edhe nga Gjermania, ku u kthyen shumë për ta rinisur jetën në Kosovën e Lirë dhe të Pavarur, e cila u kurorëzua me Pavarësinë e saj me 17 shkurt 2008.




**Fassadenarbeiten**

**Gerüstbau**

**Trockenbau**

**Renovierung - Malerarbeiten**

Geschäftsführer: Miran Hasani



# BAUDEKORATION HASANI GmbH

**Ihr Spezialist in der Fertighaus Branche**

Im Oberfeld 15
36124 Eichenzell

**Tele.**: 06659 - 6113922
**Fax**: 06659 - 611 39 23
**E-Mail**: info@baudekoration-hasani.de
www.baudekoration-hasani.de

•Fassadenarbeiten •Renovierungsarbeiten •Gerüstbau

E-mail: info@baudekoration-hasani.de

Tel: 06659 - 6113922

www.baudekoration-hasani.de

Im Oberfeld 4
36124 Eichenzell



Bibë Nokaj Miran Hasani, pronar i"Baudekoration HASANI GmbH" në Eichenzell



Kompania "Baudekoration HASANI GmbH" në Eichenzell – Fulda

# AFARISTI MIRAN HASANI, SHEMBULL SUKSESI I NJË TË RIU NË MËRGATË

Në auto-udhën, siç njihet në Gjermani, në "autobahn-in" numër 66, në dalje nga ajo për në qytetin Eichenzell diku 400-500 metra, në anën e majtë bie në sy, një godinë e madhe, e cila të krijon një përshtypje nga pozicioni dhe forma e ndërtimit, në dukje e ndërtuar, siç themi ne "në ballë të oxhakut". Tabela e madhe, që shihej në sfond nga një largësi e konsiderueshme, me mbishkrimin e emrit të kompanisë "Baudekoration Hasani GmbH", na bënte me dije, se kemi arritur pas një rruge relativisht të gjatë në cakun e dëshiruar. Pasi parkuam makinën në parkun e kompanisë, shihen në depon gjigante prej afro njëmijë metra katror, dy punëtorë duke punuar. Depoja ishte e mbushur përplot me material suvatues.

Iu themi në shqip, "Puna e mbarë, burra!", i buzëqeshur nga përshëndetja në shqip, ai na e ktheu "Mbarë paqi - Mirë se erdhët". Ky burrë i urtë, i sjellshëm dhe punëtor, i një moshe më mesin e gjashtëdhjetave, pasi i treguam kush jemi dhe qëllimin e vizitës, në bisedë e sipër na tregoi se quhej Sali Hasani, babai i afaristit të suksesshëm "Baudekoration HASANI GmbH" në Eichenzell.

Më pas hymë në zyret e kompanisë, aty me një mikpritje dhe ngrohtësi, na priti pronari i Kompanisë z.Miran Hasani. Ishte kënaqësi gjatë bisedës të dëgjosh për të arriturat dhe sukseset e afaristëve shqiptarë në biznes. Kompania "Baudekoraton Hasani GmbH" në Eichenzell, veprimtarinë e saj në afarizëm në lëmin e fasadimit e ka filluar që nga viti 2014, dhe për një kohë relativisht të shkurtër ka arritur të ketë afër 100 punëtor, kryesisht shqiptarë.

Kjo kompani, sipas afaristit Miran Hasani, është duke shënuar rezultate rekorde në cilësi dhe produktivitet, ku ka kryer punimet në fasadimin e shtëpive të gatshme, të njohura si "Fertighaus", llogaritet kompania e dytë e suksesshme në rajon. Përveç suvatimit, kjo kompani ofron montimin e skeleve, si dhe ofron material fasadues për firmat e tjera të kësaj lëmie.



Kompania në fjalë në krye me afaristin e ri në moshë dhe tejet ambicioz, me punën dhe efikasitetin e dëshmuar, ajo jo vetëm se operon në tregun e ndërtimit në Gjermani, por ajo e ka zgjeruar punën e saj edhe në Itali, Zvicër, Belgjikë, Holandë, Luksemburg dhe Austri. Afaristi Miran Hasani, i cili është nga Reçani i Therandës, me modesti flet për sukseset e kompanisë së tij, por gjatë bisedës kuptuam dhe pastaj e vizituam edhe objektin e ri të ndërtuar me një sipërfaqe prej afër një mijë metra katror, dhe oborr prej afro 30 ari, që në të ardhmen do të shërbente për qëllim të zgjerimit të kapaciteteve të kësaj kompanie në afarizëm. Kompania "Baudekoration HASANI GmbH", bashkëpunon ngushtë edhe me 17 biznese të tjera, kryesisht shqiptare dhe për punëtorët e saj ofron seminare të shumta profesionale nga ekspertët e lëmit të fasadimit.



Afaristi Miran Hasani së bashku me aktorin Kreshnik Ibrahimi ("Ich bin Albaner") dhe vëllaun Albertin


Afaristi Miran Hasani me aktorin Pëllumb Emini dhe dy kampionët e boksit Amarildo dhe Roberto Bakaj



Kompania dhe puntoret

# SOFRA POETIKE
E KRIJUESVE SHQIPTARË NË GJERMANI



**Arif BOZAGJI**

**ZARFI**

Kur në sytë e zogjve
Korbat shuanin etjen
Një familje nga Prekazi
Deshi t`ia tregoj
Një letër diellit

Asnjë zarf nuk ia zuri
Letrën e përgjakur.



**Bashkim HALILAJ**

**LISI IM**

Dikur herët patëm një Lis
Trup të gjatë, i gjerë n´mjedis
Degët të gjata, aq të forta
Që nga lâma, deri te porta!

Lisi i bukur quhej Arbëri
Me rrënjë të thella në Iliri
Degët barbarët ia prenë
Doni t´ia zhduknin ADN-në!

Erërat nuk e lëkunden vendi
As rrënjët nuk i shkuan n´gjeti
Fërfëlleza desh na ç´mëndi
Por trungu i fortë, aty mbeti!

E çka tha lisi para dymijë vjetësh
Sa me mllef e me qartësi
Mos gabo n´rrënjë t´më prekësh
Se n´truall timin jam unë aty!



**Bekim BLAKU**

**QË ATË DITË**

Ç'prej asaj dite
Edhe Dielli
Sikur ndriçon më pak
Pa mëdyshje
Që edhe koha
Tjetër ngjyrim mori
Mjegulla gjithandej
Shumëçka mbuloi
Doruntinën
Kush e solli
Shpirtra të trazuar
pati qysh moti
por asnjëherë
si atë natë tetori
Konstandini u zhduk
pa lënë asnjë gjurmë
po Doruntinën prapë pyes
kush e solli?



**Fetah MALIQI**

**MALL MËRGIMTARI**

Prej ajrit, dheut e ujit do të mbledh
Këpucë të Elbës dy varka
Dy vela të Hamburgut do të zgjedh
Gati për fluturim aty nga darka

Si Dedali e Ikariusi lart të ngrihem
Të marr krejt pa pritur arratinë
Mbi Busavatë dua të zgjohem
Që nga qielli të shikojë shtëpinë

Kur të ngopem, fshatin duke parë
Numëruar një nga një ara, shtëpi
Të shkoj ku lozja me shokë të
pandarë
Më lini rehat, se tani aty dua të rri.



**Arif MOLLIQI**

**ZOGJTË SHKUAN E S´U KTHYEN**

Shah me të vdekurit
në detin e verdhë e të pafund
kërkojmë ku është fshehur Atlantida
n' fund të detit
apo në mitet e pajeta.

Midis ditës me diell, e natës me hanë
i kanë copëtuar hartat
anijet s'mund t'i afrohen portit.

Gjarpri me dhëmbë të prishtë
ka helmuar ujin e detit
janë mbyllur rrugët
e nuk kthehen ata që shkuan

Pas pusisë që ua bëri bora e kuqe
nuk e dimë kur kthehen detarët
nga kalvari i lodhshëm udhëtimi

U ka mbetur vetëm të zhyten nën ujë
t'i numërojmë plagët
të luajnë shah me të vdekurit

Askush nuk është më i sigurt
as nga të gjallët
me pamje paqësori.



**Drita FEJZA**

### MOS I THURNI HESHTJES KURORË MBRETI!

Mos i thurni heshtjes kurorë mbreti,
kurorat janë për varre, botë pa dritare ...
në çdo kontinent
frika ka pushtuar çdo shtëpi.

T'vdesësh për bukë është më e frikshme se
t'vdesësh për liri
dhurohen tanke e kallashnikov
Dallëndysheve u prishet foleja
nga korona vdesin me miliona.

Satelitët përgjojnë, internetin në çdo shtëpi
vrasjet makabre e tjetërsuar bota shikohet në sy
Imam e priftërinj predikojnë, flasin për Zotin
Meteorologët parashikojnë motin
kërcënime bomba dhe atom
vështirë në ditë të sodit, të sillesh si njëri
të gjuajnë me thumba e me gur
njëri të shanë nënën, tjetri n'flamur
ku po vete ky njerëzim, shkon si qeni në rrush quhet
vetëflijim
çirren si papagaj mbajnë ligjërata
punët si hiçi e fjalët e gjata
mos i thurni heshtjes kurorë mbreti
kurorat janë për varre, botë pa dritare...
Bota pa dashuri do t'bëhej pluhur e hi!



**Bukurije BUSHATI**

### UDHËKRYQ

Tashmë jam mësuar me ardhjet e ikjet,
Siç erdhi dhe iku edhe kjo borë sot,
Por rituali ka mbetur ai i vjetri, ngulitur
Sytë t'i mbaj nga rruga e kthimit, më kot.

Ardhjet veç se kur i shoh tek dera,
Hap krahët i pushtoj në gjoks t'i mbaj gjatë,
Që nga ai çast më mundon ideja largimit,
Rriten tek unë dhe largohen kur hedhin shtat.

Tashmë jam mësuar me largimet,
Ndjehem udhëkryq ku zgjidhet vazhdimi.
Secili nga ne është prag, ku trokitet e iket,
Ku festohet ardhja, ku ikja ka dihatje trishtimi.



**ngjelina KRASNIQI - ENXHI**

### BIJA IME

Dje për një legjendë bisedova me tëndin vëlla,
Dhe sot dua të ta tregoj dhe Ty, e imja dhuratë,
Ta kam treguar kur ishe e vogël, si një përrallë,
Sot që mbushe të 20-tat, ta kesh me vete uratë.

Oj bijë, Rozafa e Legjendës, ishte nusja e tretë,
Dy vëllezërit më të mëdhenj bën dert me gratë,
Tradhtuar mbeti, vëllai i vogël me nusen e vet,
E murosën, mbetën n'legjendë gjallë dhe gjatë!...

“Nëna ime! Më fal se po të ndërpres kallëzimin",
Brenda meje zihet një pyetje që kërkon dritë,
Kërkoj një sqarim, tani që mori përshkallëzimin.
Pse betohemi te “Besa e Shqipëtarit " për ditë?"

"Nuk paskemi qenë para Krishtit tradhtar,
Nuk di, kjo besë, pse dhe prej nga na ka ardhur”?
Bija ime, pikërisht këtu desha që të dalë me ty,
Të kam të mençur dhe kuptove bisedën me sy!

Prandaj, lutem të kesh maturi, kur tjetrit i beson,
Goja jep besë, por ka gojë që jep dhe tradhton!
Ku ka rrënjë "Besa e Arbërit" e që vjen nga mot,
"Legjendën e Doruntinës", do ta tregojë nëna sot!

**SOFRA POETIKE**
E KRIJUESVE SHQIPTARË NË GJERMANI




# Wir bauen für Sie

Fatlum & Fatbardh Blenishta



## Schlüsselfertigbau

für Einfamilienhäuser, Doppelhäuser, Reihenhäuser und Mehrfamilienhäuser an.be.



## Ingenieurbau

Verkehrsbauten wie Brücken, Stützwände und Tunnel werden von uns mit einem hohen Grad an Professionalität und Qualität gebaut.



## Sanierung

Mit Fingerspitzengefühl werden Sanierungen, Umbauten und Aufstockungen – auch im laufenden Betrieb – von uns durchgeführt.

## KONTAKT AUFNEHMEN

Sie haben Fragen zu Projekten, zu unserem Unternehmen oder möchten ein Termin vereinbaren ? Alle wichtigen Kontaktdaten finden Sie auf dieser Seite. Nutzen Sie auch unser Online-Formular für Ihre Kontaktaufnahme.

**info@blini-gmbh.de**



Herzlich Willkommen bei Blini Bauunternehmung GmbH

Wolf
HOTEL - RESTAURANT
Zur Linde



Wernaustraße 7 - 36093 Künzell,
Deutschland

hotelzurlinde@wolfgruppe.com

www.wolfhotel-zurlinde.de

+49 661 34167

**HERZLICH WILLKOMMEN**

Pizzeria Blero

Inh: BLERIM HALILI






facebook@pizzeria-blero.de

Bronnzellerstr.
39, 36043 Fulda

https://www.pizzeria-blero.de/

Tel: 0661 96254020




ALLIANZ GENERALVERTRETUNG

Ulmen Str. 8
40476 Düsseldorf

ARDIAN KOKOLLARI
ALLIANZ GENERALVERTRETUNG

Tel.: 0211 46885144

ardian.kokollari@allianz.de

www.Allianz-Kokollari.de

**Ardian Kokollari, partneri juaj serioz në biznes. Ju ofron sigurime të ndryshme dhe financa në realizimin e ëndrrës suaj.**

# SHALA
## FENSTER & TÜREN


















Beratung

Verkauf

Montage

Kundendienst

Reparaturen

EZ
TROCKENBAU
Malerfachbetrieb









**EZ TROCKENBAU**
Malerfachbetrieb

info@ez-trockenbau.de

https://www.ez-trockenbau.de/

Tel.: 0202 295 36686
Mobil.: 0174 753 9963

Blumenstr. 30
42119 Wuppertal

Inh: Enver Zuka



AS Garten & Trockenbau

Inh: Agron Shabanaj

AS Garten & Trockenbau

- Baggerarbeiten
- Gartenarbeiten
- Pflasterstein
- Terrassen


Inh: Agron Shabanaj

as.garten.trockenbau@gmail.com

0174 6007989

Honauerstraße.3, Kehl am Rhein, Germany, 77694

# Albert GmbH
Verputz & stukkater





Inh: Admir Bytyqi



- Innenputz
- Außenputz
- Vollwärmeschutz








Albert_Stukkateur@hotmail.com
info@albert-stukk.de

www.albert-stukk.de

ALBERT GmbH
Kandelstraße 21
77694 Kehl

Tel: 01622650345
Fax: 01629619067






**Pronar**
Remzi Baftiu




**APLIKO**

dhe fillo nje jete te re ne

*Germany*

**Fillo te ardhmen me ne!**
Nëse ke TERMIN, ne ju ofrojmë kontratë pune dhe banim

## Gastronomi
Praktik deri 1 vjet ne Gastronomi...

## Hoteleri
Punesim sezonal per student...

## Ndertimtari
Shkollim profesional (Ausbildung).

## Fabrika
Punesim me kontrat pune

A keni termin në
Ambasadën Gjermane?

Atëherë mos prit,
eja dhe apliko.
Agjensioni New Way
ju mundëson të pajiseni
me kontratë pune,
pa njohuri të gjuhës.
Ju siguron vendbanim.
Asistencë e vazhdueshme
deri në marrjen e vizës!
Për me shum informata tel.

**New Way**

apliko@newway-arbeit.de

+383 45 556 955
+383 48 556 955
















info@frutex-gmbh.de

info@frutex-gmbh.de

Inh: Selajdin Gallopeni

Rastenweg 3
53489 Sinzig

0151/15503194
0152/29581716

Kryeziu
Bausanierung GmbH












BETONSANIERUNG
FASSADENSANIERUNG
PARKHAUSBECHICHTUNG
MALERARBEITEN

Inh: Shkelzen Kryeziu Gersthofen

info@kryeziu-bausanierung.de

http://www.kryeziu-bausanierung.de/

Wehrnher-Von-Braun
Straße 14
86368 Gersthofen

Tel: 0821 - 242 978 17
Fax: 0821 - 242 973 69

Autohaus Adler GmbH
UNSERE LEISTUNGEN
- Reparaturen aller Art
- Inspektion & Service
- TÜV & AU
- Klimawartung
- Unfallinstandsetzung
- Lackierungen
- Smart Repair
- Felgen Repair
- Räder, Felgen, Reifen
- Räder- / Reifeneinlagerung
- Autoglas / Scheibenreparatur
- An- und Verkauf von Gebrauchtwagen
- Ersatzteilverkauf
- Fehlerdiagnose, Programmierung / Codierung
- Tuning, Chip Tuning
ABHOLUNG UND BRING - SERVICE KOSTENLOS

ADLER immobilien
Mercedesstraße 5
71120 Grafenau

B BAME SOLAR
ERNEUERBARE ENERGIEN
SOLAR ( Privat und Gewerbe)
BATTERIESPEICHER
WALLBOX • E-MOBILITÄT

Transporti Kufomave MERGIMI
+49 170 444 03 75
+41 76 480 15 54
+33 689 35 04 04
www.mergimi.de
www.mergimi.ch
www.mergimi.fr
m.elezi8888@gmail.com
Transporti Kufomave Mergimi

FENSTER-FACHKRAFT
IHR HÄNDLER & MONTEUR FÜR
FENSTER | TÜREN | GELÄNDER | WINTERGÄRTEN | KÜCHEN | FLIESEN & VIELE WEITERE PRODUKTE
Wir können Fenster aus dem FF

Trockenbau Ardi
Inhaber: Idriz Kastrati

HOTI
Seit mehr als 20 Jahren Erfahrung!
Garten- und Landschaftbau
Hoti Nysret • Wiesenstr. 20 b • 63584 Gründau / Rothenbergen

Frutex GmbH
Selajdin Gallopeni
Geschäftsführer
Blankenheimer Str. 15
53474 Bad Neuenahr
Mobil 0151/15503194
0152/29581716
www.frutex-gmbh.de
info@frutex-gmbh.de
GOLDEN EAGLE Energy Drink

BERISHA BAU SERVICE
Markt 3 • 52146 Würselen
02405 - 60 75 011
0157 - 80 92 32 90
Berisha.Bauservice@gmail.com
Qualität und Kompetenz aus einer Hand

Kfz. Meisterbetrieb Berisha
Xhelal Berisha
Rothenditmolder-Str. 6
34117 Kassel
Tel.: 0561 - 7086996
Mobil: 0179 - 5383094
e-mail: kfz-berisha@gmx.de

Sachverständigen Büro Berisha
Xhelal Berisha
Sachverständiger
Böttnerstr. 20
34125 Kassel
Tel: 0561- 70 86 99 8
Fax: 0561- 70 86 99 90
Mobil: 0179- 5 38 30 94
E-Mail: kfz-sachverstaendiger-berisha@gmx.de

BeRi Haustechnik
Sanitär • Heizung • Solar • Klima
Ridvan Berisha
Böttnerstraße 18
34125 Kassel
Tel: 0561/47 46 90 9
Fax: 0561/47 46 91 0
Mobil: 0179/53 3 17 23
info@beri-haustechnik.de
www.beri-haustechnik.de

Rinesa 05 Shpk, me përvojë shumë vjeçare në fushën e kontabilitetit dhe financave ofron këto shërbime:
- Hapja e biznesit
- Mbajtja e librave kontabël
- Hartimi dhe deklarimi i tatimeve
- Konsulencë financiare
- Analiza financiare
- Përgaditja e pasqyrave financiare
- Hartimi i planbizneseve
- Mbyllja e bizneseve.
Rinesa ZYRE KONTABILITETI
Me pronar: Parim Kryeziu
Rr. Gjergj Kastrioti Skenderbeu-Malishevë
048-150-687
rinesa05shpk@gmail.com

ZOGAJ BAU
GIPSERGESCHÄFT

GARTEN & LANDSCHAFTSBAU
A. KASTRATI
Tel.: 0176 879 38 774

uran kycyku
ARCHITEKT
Mitglied der Bayerischen Architektenkammer
Planung & Bauleitung
M: +4915733784921
W: +38344134704
E: kycyku.uran@gmail.com
A: Goethering 18, 85570 Markt Schwaben

Isoliertechnik URBASCHEK
Inhaber A.+ B. Tafolli OHG
Wärme
Kälte
Schall
Brand
MEISTERBETRIEB
St.-Laurentius-Straße 14
36137 Großenlüder/Bimbach
Telefon (066 48) 614 18
Fax (066 48) 622 98
Mobil (0151) 15 44 05 89
E-Mail: urbaschek.tafolli@gmail.com

J.Hoxhaj GmbH
Bauunternehmen
J.Hoxhaj Bau GmbH
Windthorststr.11
67346 Speyer
01715774613
017664388598
062323120984
e-mail:jetonhoxhaj-gmbh@gmx.de

KABASHI Projekt GmbH
0841 12 85 71 11
0173 71 40 948
0162 800 700 8
info@kabashi-projekt.de
www.kabashi-projekt.de
INGOLSTADT
85057 Ettingrstr.22 - Büro
85057 Rossinistr.41

Straßen & Pflasterbau ZE GmbH.Co.KG
Straßenbau
Pflasterbau
Gartenbau
Terrassen
Natursteine
Mauerarbeiten
Trockenmauer
Gabionen.etc
Handy: 017664987347
http://www.zeqiraj-garten-pflasterbau.de
Email.info@zeqiraj-garten-pflasterbau.de

MEHMETIBAU

Mentor Krasniqi Inh.
MK Baudekoration
Im Oberfeld 15
36124 Eichenzell
Tel.: 0160/7611052
E-Mail: info-m-k@web.de
Renovierung
Trockenbau
Fassadenarbeiten

SVERKAJ Trockenbau
Kerkojm mjeshter Trockenbau
- Konstruksion
- Knauf
Te interesuarit le te lajmrohen permes email adreses sverkaj-trockenbau@gmx.de apo ne mesengjer te facebook-ut.

Tarashaj Bauunternehmen
Gartenstraße 48, 82110 Germering
+49 89 230 521 24
089 23 05 23 48
info@tarashaj-bauunternehmen.de
www.tarashaj-bauunternehmen.de

ABAU
Arsim Bytyçi
Bauunternehmen
Parlerstr.30
80937 München
Tel:017697528922
e-mail:aabau2021@gmail.com

TROJA
Balkanisches Restaurant
Pension & Kegelbahn
Dieselstraße 2 · 71404 Korb
Tel.: (049) 7151 2566780
Fax: (049) 7151 2566781
troja-korb@online.de

BC - BAU
Bauunternehmen
Maurer und Betonbauer
BLERIM Cikaqi
Mobil 0176 800 830 65 · 0176 800 830 57

85276 Pfaffenhofen
Tel. 08441/400 89 17
Handy: 0172/496 10 23
E.DUSHI STRAßENBAU
E-mail: info@dushi-pflasterbau.de
E-mail: E.Dushi-Plasterbau@hotmail.de
dushi-pflasterbau.de
PFLASTERARBEITEN * GRANITVERLEGUNG

BLENISHTI-BAU GMBH
- Hochbau
- Maurer- und Betonarbei
- Innen- und Außenputz
- Trockenbau
- Eisenflechter
Auf der Kaiserfuhr 33
53127 Bonn
kontakt@blenishti-bau.de
0177 298191
0176 724437
01773553375
Du und 4 weitere Personen

TAHIRI BAU
Meisterbetrieb

BUCOLLI
MALER & STUCKATEUR GMBH
WWW.BUCOLLI.DE
INFO@BUCOLLI.DE
TEL: 07150 / 810 54 34
FAX: 07150 / 810 54 35
STUTTGARTER STR. 24
70825 KORNTAL-MÜNCHINGEN
Profi-Service im Altbau · Sanierung aus einer Hand · Renovierungen aller Art
- Maler- & Fassadenarbeiten
- Stuck- & Putzarbeiten
- Fassadenreinigung
- Raumgestalter
- Bodenlegerarbeiten
- Wärmedämmung
- Schimmelsanierung

AS Garten & Trockenbau
Baggerarbeiten
Gartenarbeiten
Pflasterstein&Terrassen
EREICHBAR UNTER:
01746007989



Revista Periodike për MËRGATËN SHQIPTARE NË GJERMANI Nr.2 - Tetor 2024
**Kryeredaktor** Argjend Hasani; **Redaktor** Abdullah Troshupa;
**Dizajni Grafik** Rrezart Fejzullahu; **Botues:** "Lena Graphic" në Prishtinë
www.mergata-info.de
**Email:** revista-mergata@outlook.com

KRONI GmbH

Mulaku
Maler & Meisterbetrieb
Parkstrasse. 35 36110 Schlitz
Festnetz: 06642 - 3069051
Fax: 06642 - 3069052
Mobil: 01717057836
Florim Mulaku
Geschäftsführer
mulakutrockenbau@hotmail.com

JK KRYEZIU Steuerberatung

J.Hoxhaj GmbH
Bauunternehmen
J.Hoxhaj Bau GmbH
Windthorststr.11
67346 Speyer
01715774613
017664388598
062323120984
e-mail:jetonhoxhaj-gmbh@gmx.de

AL-TROCKENBAU

BB Zaunmontage
BB Zaunmontage
Bekim Balaj
Zaun-Monteur seit 2000
Westendstraße 11 a
86415 Mering
• Drahtzäune • Eisenzäune • Stabgitterzäune • Wildzäune
• Kunststoffzäune • Holzzäune • Lärmschutz • Sichtschutz
• Gabionen • Randsteine • Tore, Türchen • Elektroantriebe
Mobil: 0172/1330521 · Mail: BB-Zaunmontage@hotmail.com

DRINI MARKET

ADLER
FASSADENARBEITEN & TROCKENBAU

HOCHBAU · TIEFBAU · SANIERUNG · PUTZ
SCHLÜSSELFERTIGES BAUEN · BAUBETREUUNG
Lami Bau
HOCH & TIEFBAU GmbH
Lami Bauunternehmung GmbH
Bajuwarenstr. 2
86517 Wehringen
info@lamibau-gmbh.eu
www.Lamibau-gmbh.eu
Tel. 08234/809 53 83 · Fax 08234/809 53 84

TONI Trockenbau
Jeton Ramadani · Geschäftsführer
Renovierung & Altbau sanierung

& Schaller GmbH
DACHDECKERMEISTERBETRIEB

Kryeziu
Bausanierung GmbH

ALBERT
Verputz & Stukkateur GmbH
hlenweg 17
94 Kehl
Tel: 01629619067
Tel: 01622650345
www.albert-stukk
info@albert-stukk

EDEKA
Verbrauchermarkt
Breitenbrunn GmbH
Fitim Thaqi
Geschäftsführer
Tel.: 09495/9038910
Von-Tilly-Straße 9
92363 Breitenbrunn
Mobil: 0160 977 571 59
Email: edeka.thaqi-breitenbrunn.sb@edeka.de

GARDEN UND LANDSCHAFTSBAU
MIFTARI GROUP
HOHENTHANN - DEUTSCHLAND

BESIbau
Montageservice
Hochstadenstr. 4
53474 Bad Neuenahr Ahrweiler
Tel: +49 178 4691356
+49 177 7153749
+49 151 15560456
E-Mail: fensterbau_20@web.de

Altstadthotel
WILDE ROSE
&
Wirtskeller
Sankt Georg
Kirchgasse 29-31
75031 Eppingen
info@altstadthotel-wilde-rose.de

FR
Immobilienmanagement
Flamure Rexhepi
Immobilienkauffrau
Tel: 02302-98 361 31
Mobil: 01579-23 627 16
Email: info@frimmo.net
www.frimmo.net

New Way
Apliko dhe fillo nje jete te re ne
Punësim me kontratë pune
Punësim sezonal për studente
Shkollim profesional ( Ausbildung)
Praktikë deri 1 vjet në Gastronomi....
Hotele, Mc Donalds BaugerKing etj.
dhe shumë mundësi të tjera...

EG PROJEKTBAU GmbH

Mauer & Betonbau
SHAMOLLI

85276 Pfaffenhofen
Tel. 08441/400 89 17
Handy: 0172/496 10 23
E.DUSHI
STRAßENBAU
E-mail: info@dushi-pflasterbau.de
E-mail: E.Dushi-Plasterbau@hotmail.de
dushi-pflasterbau.de
PFLASTERARBEITEN ✶ GRANITVERLEGUNG

GLORJA
Putz- und Malerbetrieb

Pizzeria Blero

KÖNIGS-VILLEN
IMMOBILIEN GMBH

FM
Bau & Immobilien
GmbH

MK
BAUDEKORATION

SGN BAU
IHR FACHMANN
FÜR STUCKATEUR & MALER ARBEITEN

BAME
SOLAR
ERNEUERBARE ENERGIEN
SOLAR ( Privat und Gewerbe)
BATTERIESPEICHER
WALLBOX • E-MOBILITÄT

Mersini N.S
Gartenbau
Unsere Firma bietet Ihnen Qualität,Sicherheit und Schnelligkeit
Immer und überall

AS
Garten & Trockenbau
- Hausmeisterservice
- Gartenarbeit/-pflege
- Gebäudereinigung
- Bodenlegerarbeiten
- Trockenbau
- Kleinreparaturen
- Winterdienst

Trockenbau
Ardi
Inhaber: Idriz Kastrati